



REPUBLIKA E SHQIPERISE

KUVENDI

Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalim e Dhunës ndaj Gruas

Nënkomisioni për Qeverisjen Vendore

PROCEVERBAL

Tiranë, më 01.10.2018, ora 12:00

Drejton nënkomisionin:

Eglantina Gjermeni - kryetare e Nënkomisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore në lidhje me funksionimin e mekanizmit të referimit të dhunës në familje.

Marrin pjesë:

Eglantina Gjermeni, Elona Gjebra Hoxha, Klodiana Spahiu, Antoneta Dhima dhe Musa Ulqini. Bashkim Fino, Edmond Leka, Klotilda Bushka.

Pjesëmarrës nga AGD-ja:

Vasilika Hysi, Vilma Bello, Edlira Bode, Milva Ekonomi, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Blerina Gjylameti dhe Evis Kushi.

Mungojnë:

Orjola Pampuri, Floida Kërpaçi, Rudina Hajdari dhe Fatbardha Kadiu, Dhurata Çupi, Nasip Naço, Oerd Bylykbashi.

Të ftuar:

Ardiana Jaku - Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale
Merita Xhafaj – Drejtore e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale

Etleva Sheshi - përgjegjëse sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale

Ines Leskaj – drejtore ekzekutive “Rrjeti i fuqizimit të gruas në Shqipëri” (AWEN)

Aurela Bozo – drejtoreshë përfaqësuese nga “Qendra për nisma ligjore dhe qytetare”
Altin Hazizaj – drejtor ekzekutiv i CRCA-së
Linda Pino - menaxhere projekti pranë CRCA-së
Klaudio Pulaha - përfaqësues i CRCA-së
Brian J. Williams – koordinator i Përhershëm i Kombeve të Bashkuara dhe Përfaqësues i Përhershëm i UNDP-së
Edlira Papavangjeli – menaxhere e Programit për Barazinë Gjinore, Dhunën në Familje dhe Aksesin në Drejtësi i UNDP-së
Anri Pashaj – përkthyes
Edlira Haxhiymeri - përfaqësuese e “Strehëza për gratë dhe vajzat”
Mirela Arqimandriti - përfaqësuese e qendrës “Aleanca gjinore për zhvillim”
Marjana Meshi - përfaqësuese e qendrës “Të ndryshëm dhe të barabartë”
Milaim Demnushaj - përfaqësues e qendrës “Të ndryshëm dhe të barabartë”
Afërdita Prroni - përfaqësuese e qendrës “Për të drejtat e njeriut në demokraci”
Lindita Cakoni - përfaqësuese e qendrës “Për të drejtat e njeriut në demokraci”
Mimoza Hajdarmataj - drejtore ekzekutive e qendrës “Gratë në shërbim publik”
Elsa Gega - anëtare e Bordit Këshillimor të qendrës “Gratë në shërbim publik”
Adelina Farrici - përfaqësuese e shoqatës “Për autonomi vendore”
Migena Kokerit Ismailati - përfaqësuese e shoqatës “Për autonomi vendore”
Anjeza Bojaxhiu - përfaqësuese e shoqatës “Për autonomi vendore”
Ama Kraja - përfaqësuese e OSBE-së
Megi Llubani - përfaqësuese e OSBE-së

HAPET MBLEDHJA

Eglantina Gjermeni – Mirëdita!

Të futet media!

Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Faleminderit të gjithave për pjesëmarrjen në këtë seancë dëgjimore të organizuar nga nënkomisionet “Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës në familje” dhe “Për pushtetin vendor”.

Në seancën e sotme është parashikuar të diskutohet për funksionimin e mekanizmit kundër dhunës në familje dhe për këtë kemi ftuar përfaqësues nga institucionet publike qendrore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, organizata të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare, si edhe shoqata të pushtetit vendor. Vlerësojmë rolin dhe kontributin që të gjithë ju, përfaqësues të shoqërisë civile, të institucioneve keni dhënë dhe vazhdoni të japni sa i përket parandalimit të dhunës në familje, shërbimeve ndaj viktimave, si dhe përmirësimet ligjore dhe monitorimit të punës së institucioneve publike.

Do të doja të theksoja faktin që parlamenti vitin e kaluar ka miratuar një rezolutë kundër dhunës në familje dhe realisht për të parandaluar dhe adresuar çështjet e dhunës ndaj gruas dhe çështjet e dhunës në familje, duke i trajtuar si probleme shumë të mprehta të shoqërisë shqiptare. Në fakt, ishte nismë e deputeteve të Partisë Demokratike, dhe unë sërish i falënderoj. Rezoluta, si rrallë herë ndodh në parlamentin shqiptar, u votua në mënyrë unanime nga 140 deputetë. Kjo do të thotë që të gjithë ne si përfaqësues të qytetarëve, si ligjvënës kemi përgjegjësi shumë të madhe sa i përket çështjes së të drejtave të njeriut, çështjes së të drejtave të grave, të parandalimit të dhunës në familje, dhunës ndaj gruas dhe trajtimit të viktimave, hartimit të legjislacionit, monitorimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe dhënies së shërbimeve nga institucionet përkatëse.

Në lidhje me këtë rezolutë është krijuar nënkomisioni “Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas”. Ky nënkomision ka bërë një plan veprimi, në bazë të të cilit janë jo vetëm legjislacioni shqiptar, strategjia e barazisë gjinore dhe parandalimit të dhunës, por edhe raportet e organizatave ndërkombëtare në lidhje me këtë problem kaq të rëndësishëm. Sigurisht që në bazë të rezolutës, në bazë të planit të punës që ne miratuar si nënkomision, së

bashku me nënkomisionin e pushtetit vendor dhe kryetarin, zotin Fino, u kemi drejtuar të gjitha bashkive, të 61 kryetarëve të bashkive në vend nga një letër të firmosur nga të dy ne për të marrë informacion në lidhje me funksionimin e referimit të mekanizmit të dhunës, duke e trajtuar dhunën si një problem shumë serioz, duke parë nga statistikat, raportimet e institucioneve shtetërore dhe të organizatave jofitimprurëse që ka mangësi, së pari, në krijimin e këtij mekanizmi, pra jo të gjitha bashkitë e kanë krijuar mekanizmin e referimit të dhunës. Sot janë vetëm 37 bashki që e kanë krijuar dhe, së dyti, edhe aty ku janë krijuar këto mekanizma jo gjithmonë funksionojnë sa dhe siç duhet.

Letra ka qenë specifike. Bashkitë, të cilat e kanë krijuar mekanizmin, u është drejtuar një letër kryetarit në 08.06.2018, duke e pyetur në mënyrë të detajuar në lidhje me funksionimin e mekanizmit të referimit të dhunës, si edhe problematikat që kanë. Po kështu një letër specifike iu është drejtuar kryetarëve të bashkive, të cilat nuk e kanë krijuar mekanizmin e dhunës po në të njëjtën datë duke i inkurajuar, duke i treguar bazën ligjore, duke iu kërkuar që të krijojnë sa më parë mekanizmin e referimit të dhunës dhe pa dyshim duke e trajtuar problemin e dhunës jo vetëm si shkelje të të drejtave të njeriut, por edhe si një pengesë për zhvillim social demokratik në shoqërinë shqiptare. Të gjithë jemi shumë të ndjeshëm ndaj këtij problemi, i cili na shqetëson dhe prek të gjithë.

Në ndryshimet e fundit që i janë bërë ligjit për dhunën në familje më vjen shumë mirë të ndaj dy prej tyre: së pari, përfshirja në ligj e masave për dhunën familjare dhe të marrëdhënieve afektive, hapësirës ose beshllëkut që ekzistonte në ligjin ekzistues dhe nuk adresonte problematikat që ndeshin vajzat në marrëdhëniet e tyre afektive; së dyti, risia tjetër është urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes. Them se ndryshimet ligjore erdhën edhe si rezultat i punës së bërë, boshllëqeve dhe problematikave të vëna re në ligj. Tani jemi të gjithë në të njëjtin emërues të përbashkët, jemi të gatshëm për të monitoruar zbatimin e këtij legjislacioni.

Diçka tjetër që dua të them, në të gjithë këtë situatë që ndeshemi dhuna është një problem shqetësues dhe na prek të gjithëve, e gjithë situata dhe rasti i ndodhur së fundi në Krujë, është një kamanë alarmi për të gjithë ne si komision, si deputetë dhe ligjvënës. Ne jemi të shqetësuar dhe të angazhuar dhe të gatshëm që probleme dhe raste të tilla të minimizohen. Unë personalisht kam një përgjegjësi disafishe, jo vetëm si kryetare e këtij nënkomisioni, jo vetëm si deputete nënë dhe grua, aktiviste që kam trajtuar këto raste, por kam përgjegjësinë që jam një nga përfaqësuesit e zgjedhur në Krujë, deputete e Krujës, kështu që shqetësimi dhe përgjegjësia është disafish.

Më vjen mirë që këtë seancë dëgjimore e kemi organizuar me të gjithë ju pikërisht për të diskutuar lidhur me problematikën që ndeshin viktimat e dhunës, me ekzistencën ose jo të mekanizmit të referimit të dhunës, apo me mënyrën si funksionon ose jo ky mekanizëm. Pjesa më e madhe juaja i monitoron këto lloj mekanizmesh në bashkitë që janë krijuar, dhe pa dyshim që kërkoj të diskutojmë së bashku që raste të tilla të mos ndodhin më. Mundësisht të jemi të gjithë të angazhuar dhe jo thjesht me rezolutën, jo thjesht me ndryshimet ligjore, por me një përforsim të rolit monitorues të parlamentit lidhur me mekanizmat e referimit të dhunës.

Dua të ndaj me ju shumë shkurt disa nga përgjigjet e bashkive, sepse janë shumë shqetësuese. Janë 37 bashki që e kanë krijuar mekanizmin kundër dhunës, këtu sërish gjej rastin të falënderoj si përfaqësuesit e shoqërisë civile, që kanë ndihmuar, ashtu edhe angazhimin e kryetarëve të bashkive, stafet e tyre.

Prandaj edhe sot janë të ftuara shoqatat për pushtetin vendor duke kërkuar, në fakt, edhe një bashkëpunim më të thellë ndaj tyre, ndaj bashkive dhe një presion të përbashkët sa i përket monitorimit të mekanizmit të referimit të dhunës. Bashkitë që kanë ngritur dhe merren me funksionimin e mekanizmit dhe bashkërendimin e punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare janë: Bulqizë, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Himarë, Kamzë, Klos, Kolonjë, Korçë, Krujë, Kukës, Kurbin, Librazhd, Lushnjë, Mallakastër, Mat, Patos, Përmet, Pukë, Roskovec, Sarandë, Shkodër, Tiranë, Vlorë.

Bashkitë që nuk kanë zbatuar detyrimin për ngritjen e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës janë: Çorovodë, Dropull, Divjakë, Cërrik, Vau i Dejës, Vorë.

Në përgjigjet që kanë kthyer kryetarët e bashkive theksoj se në Bashkinë e Vaut të Dejës brenda këtij viti do të ngrihet mekanizmi, Bashkia Dropull është përgjigjur që nuk ka pasur raste të dhunës në familje, prandaj nuk e ka krijuar mekanizmin, bashkitë Divjakë, Cërrik dhe Vorë po marrin masa për ta zbatuar detyrimin për ngritjen e mekanizmit brenda këtij viti. Kemi edhe bashki të cilat nuk janë përgjigjur. Bashkitë që nuk kanë kthyer përgjigje janë: Belsh, Delvinë, Dibër, Devoll, Fushë-Arrëz, Finiq, Gramsh, Has, Kavajë, Këlcyrë, Konispol, Lezhë, Libohovë, Malësi e Madhe, Maliq, Memaliaj, Mirditë, Pogradec, Përrenjas, Pustec, Peqin, Poliçan, Rrogozhinë, Selenicë, Shijak, Tropojë dhe Ura Vajgurore.

Sigurisht bashkitë, të cilat kanë kthyer përgjigje që po funksionon mekanizmi i dhunës pa dyshim kanë shprehur edhe rezervat apo vështirësitë që ato kanë në punën e tyre. Për të gjitha këto

të dhëna që kanë paraqitur në nënkomision do të hartohet një raport, i cili do të botohet në faqen e Kuvendit. Realisht i lexova më shumë për të ilustruar thellësinë e problemit dhe faktin që ne dallohemi për ligje të mira, dallohemi për faktin që vërtet kemi modele të mira. Mekanizma të referimit të dhunës janë krijuar dhe duhet t'i promovojmë më shumë, por kemi jashtëzakonisht shumë punë për të bërë ne si deputetë kemi një rol jashtëzakonisht më të madh jo thjesht si pjesë e nënkomisionit, apo si aleancë e grave deputete, por edhe si qytetarë, edhe si ligjvënës, edhe si përfaqësues të popullit.

Doja t'ju thosha edhe diçka tjetër. Në gjithë këtë situatë ku po trajtohet çështja e dhunës në familje dua të vlerësoj faktin se më vjen mirë kur flasim për çështjen e dhunës në familje dhe kërkojmë forcim mekanizmesh. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se deri para disa vjetësh kjo gjë ka qenë tabu, kurse tani është rritur numri i denoncimeve, janë rritur shërbimet, janë krijuar modele institucionale qoftë edhe në pushtetin vendor shërbime nga shoqëria civile, të cilat tregojnë jo vetëm ndërgjegjësimin qytetar, por edhe angazhimin e të gjithëve ne për ta adresuar problemin.

Sot jemi këtu për të dëgjuar problematikat që ju keni vënë re nga puna juaj. Ashtu siç ju është nisur në ftesë, do t'ju lutesha që secili apo secila prej jush të nga flasë për problematikat që keni monitoruar apo ato që viktimat hasin në mekanizmin e referimit të dhunës, si mund t'i adresojmë, sepse sugjerimet konkrete do të ndihmonin të gjithëve për t'i adresuar.

Sigurisht, në qoftë se keni informacion apo raporte të monitorimit, disa prej jush na i kanë dërguar me *e-mail* dhe i falënderoj të gjithë ata që na i kanë dërguar, por do t'ju lutesha t'i depozitoni pranë nënkomisionit që ne t'i adresojmë apo t'i kemi si informacione mbështetëse për ta vazhduar më tej punën tonë.

Në seancën e sotme dëgjimore kemi të ftuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, zëvendësministren Ardiana Jaku, zonjën Merita Xhafaj, drejtore e Përgjithshme dhe zonjën Etleva Sheshi, përgjegjëse sektori. Ju falënderoj që jeni të pranishme!

Gjithashtu, do t'ju lexoj organizatat dhe përfaqësuesit e tyre, të cilët kanë konfirmuar pjesëmarrjen. Pa dyshim secili prej jush është i lirë të flasë sipas renditjes, pasi dikush do të flasë e dikush jo, kjo është e drejta juaj, pasi ne jemi të interesuar dhe të gatshëm t'ju dëgjojmë të gjithëve.

Secili prej jush ka një kohë në dispozicion prej 5 minutash. Më pas nga deputetët mund të ketë pyetje dhe në fund diskutime për t'ju lënë hapësirën e nevojshme për të diskutuar.

Të pranishëm janë: Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, AWEN, e përfaqësuar nga zonja Ines Leskaj, Qendra për Nnisma Ligjore dhe Qytetare me përfaqësuese zonjën Aurela Bozo, CRCA, Qendra për të Drejtat e Fëmijëve, me përfaqësues Altin Hazizaj, Linda Pino dhe Klaudio Pulaha. Nga UNDP, zoti Brian J. Williams, Koordinator i Përhershëm i Kombeve të Bashkuara dhe përfaqësues i përhershëm i PNUD-it në Shqipëri. Ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj, si dhe një falënderim të veçantë për ndihmën që UNDP-ja dhe UN kanë dhënë për krijimin e mekanizmit të dhunës dhe për trajnimin e profesionistëve...

(Diskutime pa mikrofon)

Strehëza për gratë dhe vajzat me përfaqësuese zonjën Edlira Haxhiymeri.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë po i lexoj të gjithë emrat e atyre që kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre.

Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim, zonja Mirela Arqimandriti, Rrjeti i Qendrave Komunitare “Sot për të Ardhmen”, e përfaqësuar nga zonja Fabjola Egro, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, e përfaqësuar nga zonja Ejnxh Pepa, Shoqata “Gruaja të Gruaja”, Shkodër, përfaqësuar nga zonjat Majlinda Andoni dhe Sindi Kola, Qendra “Vatra”, Vlorë, përfaqësuar nga zonja Brikena Puka, Qendra “Të ndryshëm dhe të Barabartë”, përfaqësuar nga zonja Marjana Meshi, Qendra për të Drejtat e Njeriut në Demokraci, përfaqësuar nga zonja Afërdita Prroni, Qendra Gratë në Shërbim Publik, përfaqësuar nga zonja Mimoza Hajdarmataj, Shoqata e Bashkive, zonja Aida Cecaj, Shoqata për Autonomi Vendore, përfaqësuar nga zonja Adelina Farriçi, UN Women, përfaqësuar nga zonja Agustela Nini dhe OSBE-ja, përfaqësuar nga zonjat Ama Kraja dhe Megi Llubani.

Do të vazhdojmë me këtë renditje dhe besoj se të gjithë janë dakord.

Fjala për ju zonja zëvendësministre dhe më pas fjalën do ta marrin një nga një gjithë të ftuarit.

Ardiana Jaku – Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të vetëqeverisjes vendore,

Të nderuar përfaqësuar të organizatave të shoqërisë civile,

Shumë shkurt do t’ju them ndryshimet ligjore që u ndërmorën gjatë vitit 2018 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në lidhje me ligjin “Për masat e dhunës në marrëdhëniet familjare”. Pasi u diskutua me komisionet e ndryshme ligjore dhe u konsultua me organizatat e

shoqërisë civile, i cili më pas ai aprovua. Risitë e këtij ligji, në fakt, kanë si qëllim përafrimin e legjislacionit tonë me legjislacionin në Europë është si më poshtë:

Përmirësimi i masave mbrojtëse të parashikuara në ligjin, kuadrin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrin të mbrojtjes me fokus të veçantë përmirësimin e masave mbrojtëse për fëmijët;

- shtimi i garancive ligjore për personat me aftësi të kufizuara;
- rritja e sigurisë që jep Policia e Shtetit nëpërmjet urdhrin paraprak të mbrojtjes së menjëhershme;
- dhënia e ndihmës ligjore falas nëpërmjet avokatëve të kualifikuar, mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
- përcaktimi i afateve të qarta procedurale për regjistrimin e kërkesës për urdhrin e mbrojtjes apo urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe për ankimimet ndaj vendimeve gjyqësore;
- përcaktimi dhe ndarja e qartë e detyrave të organeve përgjegjëse në fushën e masave kundër dhunës në familje;
- sanksionimi i masave mbrojtëse të detyrimit të dhunuesit për pjesëmarrjen në shërbimet specifike të rehabilitimit, ku një fokus të veçantë zënë dhunuesit e alkoolizuar, të droguar apo me probleme të shëndetit mendor.

Gjithashtu, edhe disa përkufizime, të cilat ju i përmendët në fillim, si marrëdhëniet intime, mekanizmi i referimit, urdhri paraprak i mbrojtjes së menjëhershme, pra specifike për këto përkufizime.

Vlen të përmenden edhe disa ndryshime ligjore të ndodhura më parë, siç është ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe ligji për strehimin social, të cilat automatikisht ndikojnë në ndihmën dhe në asistencën që u ofrohet viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Nga ana tjetër, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale po zbatohen disa strategji dhe plane veprimi, ku vlen të përmendet plani i veprimit dhe Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020, ku objektivi kryesor është rritja me 30% e numrit të individëve në shoqëri që mbështesin vizionin e strategjisë, për tolerancë zero ndaj dhunës kundër grave.

Gjatë kësaj periudhe janë rishikuar dhe miratuar një sërë strategjish apo plane të tjera veprimi të shëndetësisë, të arsimit, të pronësisë, të mbrojtjes sociale, ku janë ndryshuar masa të

veçanta me fokus përfshirjen dhe integrimin e grave apo të fëmijëve që janë pre dhe viktime të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Një çështje tjetër, për të cilën është punuar fort, është edhe buxhetimi i përgjithshëm gjinor. Si rezultat i advokimit të vazhdueshëm 2,3% e buxhetit të shtetit ndahet me iniciativa dhe investime të ndjeshme gjinore në planifikimin e buxhetit afatmesëm. Pra, aktualisht janë 28 programe sektoriale të planifikimit të buxhetit afatmesëm për periudhën 2018-2019 që kanë në fokus buxhetimin gjinor.

Në fakt, ju e përmendët që është ngritur mekanizmi i referimit të dhunës në marrëdhëniet familjare në 37 njësi, por janë shtuar edhe dy njësi, bashkia Gramsh dhe bashkia Belsh. Aktualisht janë 39 mekanizma të ngritur. Dua t'ju theksoj se ky është një detyrim ligjor, i cili i shkon vetëqeverisjes, njësite të vetëqeverisjes vendore. Nga ana tjetër ne nuk mund t'i lejmë pa mbështetje dhe pa suport, jo vetëm t'i monitorojmë, por edhe t'i mbështesim mekanizmat e krijuar dhe për këtë arsye kemi zhvilluar trajnime. Nga sektori i barazisë gjinore dhe i përfshirjes sociale janë zhvilluar trajnime dhe do të vijojë puna për fuqizimin e kapaciteteve të këtyre punonjësve.

Fokus të veçantë kanë edhe standardet e shërbimeve sociale që ne ofrojmë. Dua t'ju përmend shkurtimisht 4 çështjet mbi të cilat ne po punojmë për ofrimin e standardeve shoqërore: Qendra Kombëtare e Rehabilitimit të Viktimave të Dhunës në familje që është një qendër kombëtare, janë strehëzat emergjente, për të cilat në fakt detyrimin ligjor e kanë njësitë e vetëqeverisjes vendore, sidomos me ndryshimet e reja ligjore që u bënë në korrik të këtij viti. Janë bërë ndryshime në VKM-të nr. 116 dhe nr. 117 për linjën kombëtare të këshillimit për gratë dhe vajzat. Gjithashtu, si detyrim të ndryshimeve ligjore, kemi edhe modelin për qendrat e viktimave të dhunës seksuale, për të cilën po punojmë në ministri dhe besojmë se deri në fund të vitit do ta kemi gati një model të tillë, ashtu siç e kemi përcaktuar edhe në ndryshimet ligjore, i cili më pas do të replikohet edhe në rajonet e tjera.

Mjaft i rëndësishëm për ne ngelet jo vetëm shërbimi social që u japim viktimave, por edhe shërbimet e tjera me fokus shërbimin shëndetësor, strehimin e tyre, por një rëndësi të veçantë i japim edhe punësimit dhe arsimit profesional. Kuptohet se këto nuk i bëjmë dot vetëm, por me mbështetjen sidomos të njësite të vetëqeverisjes vendore dhe trajtimit në total të rasteve. Për këtë arsye është ngritur sistemi elektronik, ku çdo rast që referohet dhe që ndiqet përshkruhet në këtë sistem deri në momentin e rehabilitimit të plotë, pra deri në momentin kur nuk ka më nevojë për asistencë nga shteti, qoftë nga qeveria qendrore, por edhe nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Më lejoni shkurtimisht t'ju përmend disa shifra të raportuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë periudhës janar-qershor 2018.

Nga Qendra Kombëtare e Viktimave të Dhunës në Familje janë trajtuar 40 përfitues, nga të cilët 16 gra dhe 24 fëmijë dhe nga këta fëmijë 16 vajza dhe 8 djem. 14 përfituesve u është ofruar punësim në bashkëpunim me biznesin privat dhe me zyrat e punësimit në Tiranë, zyra e punësimit në Bashkinë Tiranë dhe zyra e punësimit në Kamëz, por vetëm 6 prej tyre kanë pasur mundësinë ta ndjekin punën.

Për sa i takon strehimit social 2 përfituese janë mbështetur me plotësim dokumentacioni në terren në Tiranë dhe në qytete të tjera të origjinës, për të plotësuar dosjen e aplikimit për strehim social. Dy përfituese kanë përfituar bonus qiraje nga Bashkia e Tiranës në masën 100%, ndërsa të tjerat janë në pritje. Janë integruar 4 gra së bashku me fëmijët e tyre, 7 fëmijë për këto 4 gra. Kjo luftë e përbashkët nuk mund të kuptohet nëse ne nuk përqendrohemi dhe nuk e bëjmë këtë gjë edhe nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese dhe sensibilizuese, të cilat i kemi parë si mënyrë efektive për të dhënë mesazhin e duhur dhe për t'i ndërgjegjësuar të gjithë qytetarët, jo vetëm kur janë dëshmitarë, por edhe gratë, vajzat dhe fëmijët që përjetojnë dhunë në marrëdhëniet familjare.

Çdo vit organizohen fushata 16-ditore për dhunën në marrëdhëniet familjare. Fushata e vitit 2017 kishte sloganin “Fund dhunës ndaj grave dhe vajzave” dhe po përgatitemi që edhe këtë vit të kemi një fushatë që do të jetë gjithëpërfshirëse dhe do të targetojë personat që kanë nevojë për të rritur sensibilitetin e tyre dhe për të reaguar në mënyrë të menjëhershme.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Jaku!

A ka pyetje?

Diskutimet do t'i bëjmë në fund.

Zonja Hysi, e ka fjalën.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Gjermeni!

Ju falënderoj që iu përgjigjët ftesës së dy nënkomisioneve lidhur me çështjen e ngritjes dhe të funksionimit të mekanizmit të referimit të dhunës në familje!

Kam një pyetje për ju, zonja Jaku. E para, a ka Ministria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies një *database* të organizatave të shoqërisë civile të akredituara, të cilat ofrojnë shërbime jashtë Tiranës?

E dyta, ju thatë që po asistoni në ngritjen e mekanizmin të referimit të dhunës në familje dhe përmendët trajnimet lidhur me bashkitë e tjera, pra me 34 bashkitë, ku mekanizmi nuk është ngritur. Keni një plan veprimi konkret si do të asistohen?

Së treti, çfarë do t'u sugjeronit këtyre dy nënkomisioneve, por edhe Kuvendit të Shqipërisë lidhur me buxhetin që duhet diskutuar dhe transferuar organeve të qeverisjes vendore për ngritjen e këtij mekanizmi? Keni një vlerësim të problematikës në 34 bashkitë që nuk e kanë këtë mekanizëm, por njëkohësisht edhe vlerësim të punës së mekanizmit në 37 bashkitë ku është ngritur mekanizmi? Besoj se ndajmë të njëjtin mendim, jo kudo vepron në të njëjtën mënyrë.

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Ju falënderoj!

Falënderoj edhe zëvendësministren për prezantimin që bëri!

Kisha një pyetje në lidhje me planin për fushatat ndërgjegjësuese që duhen ndërmarrë në të gjithë Shqipërinë. Mendoj se është tërësisht e pamjaftueshme që të vazhdojmë vetëm me ndryshime ligjore pa ndërmarrë fushata të mirëfillta ndërgjegjësimi në të gjithë Shqipërinë të koordinuara edhe me pushtetin lokal, me organizatat që merren me çështjen e dhunës në familje, ose edhe me dhunën ndaj gruas. Pra, çfarë planveprimi apo planfushatash keni ndërmarrë?

Do të doja të dija diçka më shumë, sepse mendoj që kurrsesi nuk do të mundemi ta luftojmë këtë lloj fenomeni thjesht me ndryshime ligjore dhe as me forcime të masave. Do të duhet që, së pari, të ndërgjegjësojmë dhe, së dyti, duke bërë një thirrje edhe për ministritë e tjera dhe përfaqësuesit e tyre, të intensifikojnë më tepër edukimin që në fëmijëri të hershme për dhunën, për respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbi të gjitha për të ç'rrenjosur një lloj mentaliteti, ku gruaja është qenie inferiore shpeshherë, apo ajo çfarë ndodh në ditët e sotme në periferitë e largëta, por edhe në familjet në mes të Tiranës, ku gruaja dhunohet, sepse e quajnë si një të drejtë të burrave.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit, zonja zëvendësministre, për paraqitjet që bëtë!

Më ngacmoi diçka në fjalën tuaj dhe do të doja t'ju pyesja për të pasur një sqarim më të hollësishëm: thatë që keni punuar shumë mirë dhe keni ndjekur një numër të caktuar rastesh të viktimave të dhunës në familje dhe keni shkuar edhe më tej në drejtim të rehabilitimit të tyre dhe të punësimit, kur ka qenë e mundur. U keni gjetur mundësi punësimi pranë bizneseve private ose nëpërmjet zyrave të punësimit, por ndërkohë ju shtuat që vetëm 6 nga këto gra ose vajza kanë

pasur mundësi të ndjekin punën. Pyetja ime në këtë rast është: mund të na thoni se për cilat arsye nuk kanë pasur mundësi ta ndjekin punën? Me këto gra dhe vajza që nuk mund të ndjekin punën çfarë do të ndodhë më tej?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Gjermani!

Faleminderit të gjithë përfaqësuesve që janë sot këtu!

Do të doja të fokusohesha pak te problematikat, sepse të gjithë duhet të na kuptoni, arsyeja që organizojmë këtë dëgjese është që të kuptojmë realisht cilat janë problemet që do të duhet të investohemi me mekanizma konkretë për të gjetur zgjidhje sa më parë.

Pa dashur të përsëris ato që tha zonja Gjermani, duke referuar situatën si ka qenë dhe si jemi, ka shumë përmirësime, jo vetëm te fakti i zgjerimit të gamës së mbrojtjes, çka do të thotë se sot viktima edhe nëse nuk është e martuar, por bashkëjeton me dikë, edhe nëse ka një partner intim, patjetër ka të drejtë të përfitojë, edhe nëse viktima tërhiqet, janë organet ato që e vazhdojnë procesin deri në fund dhe një sërë masash të tjera të marra, siç janë mekanizmat e referimit të dhunës pranë njësive të pushtetit vendor, aty ku, në fakt, realisht është edhe përqasja e parë e qytetarit me pushtetin edhe kur kërkohet ndihma.

Ajo që unë dua të kuptoj nga të dhënat që paraqiti edhe zonja Gjermani, por edhe nga përfaqësuesja e ministrisë, është: në fakt, jam informuar që janë edhe dy bashki të tjera që sapo e kanë ngritur sistemin e mekanizmit të referimit, Bashkia e Gramshit dhe Bashkia e Belshit, por nuk kemi një përgjigje zyrtare. Më bëhet qejfi dhe e përshëndes këtë nismë dhe nxis edhe bashkitë e tjera që të ecin në këtë rrugë.

Në ato bashki ku është ngritur mekanizmi dhe nga problematikat që kanë dalë, rezulton se fakti që ekzistojnë këto probleme vjen nga arsye buxhetore, nga mungesa e një personeli të kualifikuar, nga një mungesë bashkëpunimi e të gjithë aktorëve që janë pjesë e mekanizmit, apo të gjitha këto së bashku?

Në ato bashki që nuk janë ngritur, është pikërisht një çështje e vullnetit apo e mangësive reale, sepse është shumë kollaj t'u themi institucioneve që nuk e keni bërë mirë punën dhe sigurisht këtu jemi, por duhet të jemi konkretë. Pra, çfarë duhet të bëjmë të gjithë më shumë? Nëse është çështje buxheti, kemi në diskutim së afërmi çështjen e ligjit të buxhetit të shtetit, i cili do të vijë për shqyrtim. Për këtë kemi diskutuar edhe me zonjën Gjermani dhe me të gjitha koleget që do të kërkojmë të dhëna statistikore për buxhetin konkret që u është alokuar bashkive për vitin që lamë

pas dhe për atë që do të kërkohet për vitin që vjen, se sa jepet realisht për funksionimin e mekanizmit të referimit të dhunës.

Kjo është një analizë që e them jo vetëm në formë pyetjeje, por edhe për reflektim nga të gjithë aktorët që janë këtu, në mënyrë që, nëse duam të bëjmë një gjë konkrete dhe t'u vijmë në ndihmë për ta ulur këtë fenomen, të gjithë duhet të bëjmë pjesën tonë. Informacioni është parësori, pra duhet të studiojmë se nga vijnë këto probleme, vijnë nga mungesa e fondeve, nga mungesa e stafit cilësor, sepse mund të kemi bërë trajnime, por një punonjës në Bashkinë e Tiranës ka më shumë aftësi se një punonjës në bashki tjetër, pa i paragjykuar, sepse edhe eksperiencia që mund të ketë një punonjës në një bashki, mund të jetë e ndryshme nga një punonjës në një bashki tjetër. Pra, na duhet të flasim njëzëri për cilësi dhe në të njëjtën kohë t'i kemi të gjitha këto informacione që ta prekim problemin për ta zgjidhur atëherë kur duhet.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni - Faleminderit, zonja Ferhati!

Edhe unë kam një pyetje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë do të thosha, por po ta jap fjalën. Jemi bashkëkryetarë.

Bashkim Fino – Falënderoj të gjithë të pranishmit, zëvendësministren dhe të gjitha OJQ-të, në mënyrë të veçantë zonjat deputete për pyetjet shumë interesante që bënë, që janë vërtet për t'u vlerësuar!

Kam përshtypjen se nuk e kemi filluar mirë. Unë do të doja, për shembull, si përfaqësues që mbuloj një nënkomision për pushtetin vendor, ministria e linjës dhe shoqatat e bashkive të flasin në fund, të inkasojnë, të marrin, të na bëjnë një rezymë të shkurtër për mekanizmin e referimit të dhunës në familje, pasi këto kanë bërë një mekanizëm ose një observacion të tillë dhe, pasi të mbarojnë të gjitha OJQ-të, ministria e linjës, ose edhe shoqatat e bashkive, për të cilat ne si dy nënkomisione duhet të marrim më shumë detyrime për të rregulluar diçka ligjore apo buxhetore në fund të këtij viti, dhe ne të vendosim se çfarë do të bëjmë. Në qoftë se do të bëjmë pyetje përgjigje vetëm me zëvendësministren e linjës, kam përshtypjen që aneksojmë këta që kanë ardhur dhe janë zë më i fuqishëm për problemet në të cilat ndodhen.

Do të sugjeroja që zëvendësministrja i mbajti pyetjet shënim dhe duhet t'i ketë në konsideratë, të vazhdojnë të flasin përfaqësuesit e OJQ-ve për monitorimet që kanë bërë që edhe

ne të marrim parasysh se çfarë ka ndodhur në këtë kohë dhe në fund të bëjmë një rezymë të përgjithshme.

Faleminderit, bashkëkryetare!

Eglantina Gjermeni - Faleminderit, zoti Fino!

Do të thosha të njëjtën gjë, meqenëse pyetjet u mbajtën shënim, do t'ju kërkoja mirëkuptimin që t'i përgjigjeni në fund, pasi të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile të japin sugjerimet.

Kam një pyetje, edhe për këtë e dua përgjigjen në fund: edhe për shkak të ndjeshmërisë së rastit të Krujës, do të kërkoja të jepni një përgjigje si ka reaguar apo jo mekanizmi i referimit të dhunës në bashki? Si është trajtuar, apo jo, vajza, unë i them e mbijetuara, nuk e quaj dot as viktimë?

Në rastin konkret përdorimi i emrit dhe mbiemrit të plotë nga gjithë shoqëria civile, media, politika është tërësisht i gabuar, sepse ritraumatizohet dhe riviktimizohet, sepse ajo që vuan nga të gjitha këto, është vajza dhe familja e saj. Kërkoj nga ju, edhe për shkak të ndjeshmërisë, ne sot kemi në diskutim çështjen lidhur me mekanizmin e referimit të dhunës, po rasti në fjalë është vërtet shumë shqetësues dhe të gjithë e dënojmë dhunën si e patolerueshme, por duam që ky rast të mos përsëritet më, ndaj edhe jemi mbledhur sot.

Në fund, siç thamë, kërkojmë mirëkuptim!

Të ftuar kemi OJQ-në “Rrjeti për Fuqizimin e Grave në Shqipëri”, që e përfaqëson zonja Ines Leskaj. Ju keni bërë një monitorim të disa bashkive, apo jo?

Fjala për ju.

Ines Leskaj – Faleminderit që na keni thirrur sot për të ndarë shqetësimet dhe problematikat!

Monitorimi, në fakt, është bërë nga një anëtare e rrjetit tonë, organizata “Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim” në bashkëpunim me shumë anëtare të bashkive të ndryshme të Shqipërisë. Kështu që besoj për monitorimin do të flasë organizata “Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim”. Unë do të bëj shkurtimisht vetëm një përmbledhje të problematikave që kemi vite e vite që i ndajmë dhe që janë problematika të nxjerra jo thjesht pas një monitorimi të shkurtër kohor, por pas një monitorimi disavjeçar, do të thosha, që nga fillimi i zbatimit të mekanizmit.

Një pjesë e problematikave u përmendën nga ju, por unë do t'i ritheksoj.

Si fillim, do ta filloj me rolet dhe pozicionet e paqarta të secilit anëtar të mekanizmit në marrjen e detyrave dhe përgjegjësi që ata kanë, sidomos gjatë menaxhimit të rasteve. Këtu flasim për grupin teknik që duhet të ketë ky mekanizëm dhe rolet e gjithsecilit.

Shumë herë, pikërisht këta anëtarë janë të paqartë, pavarësisht se VKM-ja dhe shtojca e ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” janë shumë të qarta, por gjithsesi, me sa duket, nuk është shumë i qartë roli dhe detyrat e tyre për të gjithë përfaqësuesit e mekanizmit.

Meqenëse na keni kërkuar edhe disa sugjerime konkrete, mendojmë se ndoshta një manual i unifikuar ose një dokument i shkurtër i unifikuar ku të kenë të përshkruar rolet dhe detyrat e mekanizmit të referimit për secilin anëtar, ose kanalet dhe mënyra e shpërndarjes së informacionit, për shembull, apo formulari i konfidencialitetit që ju e përmendët, forma e analizës së riskut të rastit, të gjitha këto mund të jenë pjesë e grupit teknik, por ka nevojë të qartësohen për secilin nga organizmat.

Një problematikë tjetër që kemi parë sidomos në nivel të bashkive është pjesa kur një pjesë e madhe e rasteve të dhunës, kryesisht në zonat rurale, nuk raportohen fare nga njësitë administrative. Problematika është shumë e madhe aty dhe mbetet shumë e madhe edhe problematika e ndërhyrjes dhe menaxhimit të rasteve lidhur me rastet e dhunës në familje.

Institucionet lokale që janë pjesë e mekanizmit të referimit, që janë njëkohësisht edhe përgjegjëse për zbatimin e ligjit të dhunës në familje, në shumë raste të mbledhjeve që zhvillohen nga bashkia për të menaxhuar rastet e dhunës ose për të diskutuar për problematikat e dhunës, dërgojnë përfaqësues të ndryshëm të institucioneve. Kjo përsëri është e lidhur me mungesën e qartësimin të roleve dhe në këtë mënyrë nuk sigurohet dot një ekip i specializuar për t’i dhënë ndihmë konkrete rastit.

Mbledhjet nuk zhvillohen në mënyrë frekvente, as ato mbledhje, të cilat parashikohen me VKM nuk zhvillohen nga mekanizmi, sidomos në ato raste dhe në ato momente kur këto mbledhje duhet të raportohen.

Një problem tjetër që ne kemi vënë re është mungesa e përhershme e përfaqësuesve të gjykatës, prokurorisë dhe përmbarrimit në këto mbledhje të mekanizmit, pavarësisht se janë anëtarë të mekanizmit. Përsëri këtë ne e lidhim me e qartësimin e rolit që ka secili prej anëtarëve të mekanizmit.

Një problem që kanë organizatat tona të rrjetit, megjithëse ky është një shërbim shumë i rrallë dhe shumë i munguar në Shqipëri, është shërbimi ndaj burrave dhunues. Pra, pikërisht është

referimi i dhunuesve në qendrat e këshillimit, sepse gjithsej janë dy qendra këshillimi, një në Shkodër dhe një në Tiranë, për burrat dhunues, që synojnë ndryshimin e sjelljeve të dhunshme. Ky aspekt duhet trajtuar me përparësi, sepse është e nevojshme që të rritet bashkëpunimi me gjykatat dhe Shërbimin e Provës për të dhënë masa ndaj dhunuesve për pjesëmarrje në seancat e rehabilitimit. Ky shërbim nuk duhet parë në perspektivën e marrjes së masave ligjore ndaj dhunuesit, duke e detyruar atë të ndjekë seancat e rehabilitimit, por edhe ta detyrojë dhunuesin të kërkojë ndihmë për ndryshimin e sjelljeve të dhunshme.

Ne jemi të vetëdijshëm që është një shërbim i munguar dhe i rrallë, por të paktën të përdorim këto shërbime që janë.

Së fundi, që t'u lë kohë edhe kolegëve të flasin, ajo me të cilën e lidhim në mekanizmin është pikërisht ofrimi i shërbimeve sociale. Ajo që ka më shumë rëndësi për ne është mungesa e buxheteve, sidomos në bashkitë përkatëse, të përshtatshme për shërbimet sociale. Këto viktima në fund të ditës duan shërbime. Edhe në qoftë se mekanizmi dhe anëtarët e mekanizmit janë të përgjegjshëm, koordinohen shumë mirë së bashku, në fund të ditës ata nuk dinë se çfarë shërbimi t'u ofrojnë, me përjashtim të atyre rasteve kur në bashki të ndryshme ekzistojnë edhe streha emergjence ose përgjigjet Qendra Kombëtare për Pritjen e Viktimave, por, nga ana tjetër, mungojnë shërbimet sociale konkrete.

Lidhur me buxhetin e shtetit, doja të shtoja se duhet të rikonsiderohet pjesa e shërbimeve sociale, me qëllim që të ofrohet ndihmë konkrete për të gjitha viktimat e dhunës në familje.

Këto kisha unë në mënyrë të përmbledhur. Sugjerimet tona do t'i paraqesim me shkrim për të gjitha problematikat.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Leskaj!

Mendoj se jemi në momentin e duhur, sidomos tani që do të diskutohet edhe projektbuxheti, që të ngremë zërin për pjesën e shërbimeve sociale, ndaj ju falënderoj shumë për punën tuaj!

Unë mendoj që pyetjet t'i lemë për në fund, pasi dua t'u jap mundësinë të gjithëve të flasin. Ju lutem, mbajini pyetjet shënim, sepse kështu kam merak se nuk do të arrijmë dot. Sipas renditjes që lexova në fillim, fjalën e ka zonja Aurela Bozo nga Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare

Aurela Bozo – Përshëndetje!

Në fakt, Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare ofron shërbime ligjore falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore, përfshirë këtu edhe viktimat e dhunës në familje. Kjo është mënyra më e mirë e monitorimit për të parë sesa efektive janë mekanizmat e referimit në nivel vendor.

Së pari, dua t'ju falënderojmë zonja Gjermani për ftesën që na bëtë për këtë seancë dëgjimore, sepse e vlerësojmë shumë!

Së dyti, ne e vlerësojmë shumë faktin se ndryshimet e ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” iu nënshtuan një konsultimi shumë të gjerë me shoqërinë civile. Këtu ndaj edhe perspektivën e Rrjetit të Monitorimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore, të cilën Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare koordinon me mbështetjen e UN Women.

Së treti, do të vlerësoja shumë punë e Kuvendit të Shqipërisë lidhur me përgatitjen e rezolutës për mbrojtjen e mbrojtësve së të drejtave të njeriut.

Rasti i fundit i vajzës me inicialet XH.M tregon se sa e rëndësishme është miratimi i një rezolute të tillë. Nga ana tjetër, e rëndësishme është edhe perspektiva e mbrojtjes së të drejtave të grave në këtë rezolutë. Në fakt, ditët e fundit kanë treguar pikërisht rëndësinë dhe specifikën që kanë mbrojtësit e të drejtave të grave. Ne të gjithë e kemi shumë të qartë që këto çështje janë të lidhura me çështjen e nderit, çështjen e traditës e të tjerë.

Gjithashtu, unë dua të falënderoj edhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për punën që ka bërë deri tani, natyrisht me mbështetjen shumë të rëndësishme të PNUD-it dhe UN Women për ngritjen e këtyre mekanizmave të referimit apo edhe të donatorëve të tjerë! E vlerësojmë shumë dhe e inkurajojmë fort për fuqizimin e mekanizmave ekzistues, si dhe në ngritjen e këtyre mekanizmave në të gjitha bashkitë e vendit, ndryshe do të kemi viktimat të radhës shumë shpesh.

Çështja e dytë ka të bëjë me miratimin e ndryshimeve në ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, gjë të cilën ne vlerësojmë shumë përgatitjen dhe miratimin sa më shpejt të akteve nënligjore, në mënyrë që këto ndryshime të përkthehen në një mbrojtje reale dhe të rrisin sigurinë e viktimës. Ne presim me padurim që urdhri paraprak i mbrojtjes, që do të lëshohet menjëherë nga policia, do ta bëjë zero boshllëkun në mbrojtjen dhe sigurinë e viktimave.

Shqetësimi tjetër, që dua të ndaj me ju, është një shqetësim shumë teknik, si tekniciene që jam, por edhe si avokate që punoj çdo ditë me viktimat e dhunës në familje, duke marrë shkas edhe nga rasti i fundit, por jo vetëm. Ajo që unë do të doja të theksoja fort është se aktorët në nivel vendor, anëtarë të mekanizmave të referimit, nuk koordinojnë sa duhet, pavarësisht hapave që

kemi hedhur. Të gjithë e dimë se viktimat e dhunës raportojnë sidomos në polici dhe është e pafalshme që policia të mos referojë rastin e viktimës së dhunës tek aktorët e tjerë. Rasti i fundit ka treguar pikërisht këtë gjë.

Shoqëria civile është përballur me komente nga më të ndryshmet, ndërkohë që ka munguar një nga momentet më kryesore. Të gjithë e dimë që secili nga aktorët nuk ka për detyrë vetëm të ofrojë shërbimet e tij, por edhe të referojë rastin në mënyrë që shërbimet të merren të koordinuara. Ajo që ka ndodhur është se policia ka ofruar atë çfarë ka ofruar dhe nuk e ka referuar rastin tek aktorët e tjerë. Kështu që unë do ta theksoja fort këtë gjë, sepse neve na ngelen viktimat e dhunës në familje jashtë sistemit. Për arsye se ato në emër të mbrojtjes i drejtohen policisë, aktorët e tjerë nuk arrijnë dot që të ofrojnë shërbimet e duhura.

Një nga arsyet pse policia nuk e bën këtë gjë, kjo lidhet ngushtë edhe me problemin që ndau zonja Ines, është se sa shërbime kemi ne. Në qoftë se njësi administrative Nikël, nga vinte rasti i vajzës XH.M, nuk ofron asgjë, policia mund të mendojë pse duhet që ta referojë te kjo njësi administrative. Pra, janë të lidhura ngushtësisht, pavarësisht se e ka detyrim ligjor dhe duhet ta bëjë. Unë dua të theksoj edhe faktin që duhet patjetër të kemi shërbime në nivel vendor, në mënyrë që të funksionojë më mirë koordinimi, sepse nëse nuk ka shërbime ligjore falas, shërbime psikologjike falas, shërbime psikologjike për fëmijët, për punësim e të tjerë, atëherë edhe koordinimi nuk do të funksionojë siç duhet.

Dua të theksoj edhe diçka të fundit, që siguria e viktimës është shumë e rëndësishme. Natyrisht, menaxhimi i rrezikut është një risi që ka sjellë ndryshimet e fundit dhe shpresojmë që të sjellë ndryshime. Rasti i fundit i vajzës XH.M, në qoftë se do të flasim për menaxhim rreziku, tregon se duhet të vlerësohet rreziku shumë i lartë që paraqet rasti dhe policia duhet të ofrojë sigurinë maksimale.

Organizata e Rrjetit të Monitorimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore e ka kontaktuar vajzën disa ditë para se ne të bënim deklaratën për shtyp dhe i kemi ofruar shërbimet tona, sepse ne e masim punën tonë me shërbime dhe kjo është detyra jonë kryesore. Ne e kemi informuar vajzën që ofrojmë 1, 2, 3 dhe 4 shërbime. Përgjigjja e saj ishte: “Në këtë moment nuk jam e gatshme të marr shërbime”. Pse? Sepse duhet siguri, duhet që sistemi të ofroj siguri që ajo të marrë këto shërbime. Me kënaqësi ne duam të ndajmë me ju se sot kemi marrë një përgjigje të gatishmërisë për t’i ofruar shërbimet tona ligjore. Dy avokatet tona të Qendrës për Nisma Ligjore dhe Qytetare do t’i ofrojnë rastit shërbime ligjore falas për çështjen. Ky është hapi i parë shumë i

rëndësishëm dhe ajo që do të ndodh në ditët në vijim është që sa më shumë siguri do t'i ofrojë sistemi viktimës, aq më shumë do të rritet gama e shërbimeve që ne do t'i ofrojmë asaj, duke filluar nga shërbimi ligjor falas, që do t'ia ofrojmë menjëherë, do të arrijmë ta shoqërojmë atë me shërbimet që do të ofrojnë organizatat e tjera në të gjithë vendin.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Bozo, për gjithçka që sollët, për gjithë punën që bëni, por edhe për sugjerimet konkrete! Në mënyrë të veçantë do t'ju falënderoja edhe për ofrimin e mbështetjes ligjore për rastin e vajzës XH.M.

Megjithëse ne, si grup deputetësh, gjejmë rastin dhe momentin për të ritheksuar faktin se i mbështesim organet e drejtësisë dhe prokurorinë që t'i shkojnë deri në fund hetimit dhe të zbulojnë përgjegjësitë institucionale se çfarë nuk ka funksionuar realisht dhe kush janë përgjegjësit, që ky rast të mos ndodhë më. Ne dimë që jo vetëm në Shqipëri, por kudo në botë ndodhin rastet të dhunës në familje. Mbase nuk jemi të plotfuqishëm për t'i parandaluar të gjitha, por të paktën sistemet të jenë dhe të funksionojnë.

Vazhdojmë me zotin Altin Hazizaj nga Qendra për të Drejtat e Fëmijëve (CRCA).

Zoti Hazizaj, fjala për ju.

Altin Hazizaj - Në fakt, unë dua të falënderoj dhe të them se jam një nga horrat, që Kryeministri ka akuzuar për denoncimin e rasteve të dhunës ndaj vajzave dhe grave! Unë jam një horr i lumtur, sepse nuk ka gjë më të tmerrshme sesa Kryeministri i vendit të akuzojë njerëz, të cilët marrin përsipër të denoncojnë dhunën e vajzave dhe grave, edhe kur kanë arsye personale! Në rastin tim unë nuk kam arsye personale, por po nisem nga komenti i fundit i tij.

Kryeministri i vendit vjen nga e njëjta parti, ashtu si edhe ju, dhe për mua është e pafalshme që të gjitha rastet që denoncohen (unë e kam marrë personale atë koment), shteti nuk investon asnjë lek për ne, zero qindarka dhe përsëri ne marrim akuza. Madje zonjat këtu kanë qenë nën presion të jashtëzakonshëm, sepse dje deri në 12 të natës ne kemi shkëmbyer email-e se si t'u përgjigjemi akuzave të medias se shoqëria civile nuk bën asgjë. Akoma më e tmerrshme, përpos akuzave të medias, dhe më vjen mirë që të gjithë janë këtu, është se ne duhet të merremi edhe me akuzat e Kryeministrit shqiptar, se ne jemi horra! Kjo për mua është e pafalshme. Kjo do të thotë se përgjegjësia nuk është thjesht ligjore, sepse ka përgjegjësi ligjore, por ka edhe përgjegjësi politike.

Unë do t'ju ftoja, në mënyrën më serioze të mundshme, që të analizoni se cilat janë përgjegjësitë politike në rastin konkret. Unë do t'ju ftoja të kthejmë pak vëmendjen në qershor të këtij viti. Ka një reagim nga rrjeti “Vepra për fëmijët”, (ne jemi pjesë e disa rrjeteve) për të cilin unë punoj, për sa i përket dhunës në familje. Në lidhje me rastin e vajzës 15-vjeçare XH.B në qytetin e Pogradecit, ku pavarësisht se vajza e kishte pranuar se ishte viktimë e përdhunimit nën moshën 14 vjeç, pavarësisht se autori e kishte pranuar autorësinë e kryerjes së veprës penale, gjykata e Korçës e dënoi atë vetëm 4,5 vjet burg. Këtë gjë ne e shikojmë me shqetësim dhe thirrja për këtë nënkomision, për parlamentin dhe për çdo deputet është: mosdëgjimi e vret viktimën.

Mua më preku pak edhe komenti i bërë nga zonja Ilda, pjesë e shoqërisë civile. Këto nuk janë probleme të reja dhe nuk dua të them se kanë 28 vjet, sepse e kuptoj që Shqipëria ka qenë varfër dhe ne mund të kemi pasur mungesë të dijeve e të tjerë, por kanë mbi 10 vjet. Të gjithë përqafohemi, puthemi, madje i kemi përdorur të gjitha mënyrat për të ngritur shqetësimin se dhuna ndaj vajzave dhe grave nuk është thjesht proverb, sepse i dimë numrat, por po na vret të gjithëve. Krimi nuk ndikon vetëm te viktima, por tek e gjithë shoqëria. Çdokush që shikon një vajzë, e cila gjendet në një situatë të tillë, do të mendohet jo njëherë, por 10 herë për të denoncuar krimin e radhës. Pse? Sepse do të mendojë se ka një kryetar bashkie, i cili mbase do të marrë në telefon dikë dhe t'i thotë të mos bëjë asnjë gjë; ka një shef policie që do ta marrë në telefon punonjësën e policisë dhe do t'i thotë mos bëj asnjë gjë, mund të ketë edhe deputetë që bëjnë të njëjtën gjë dhe nuk e dimë.

Ne kemi dy propozime konkrete, të cilat po i ndaj ne ju, sepse njëra ka të bëjë me rastin konkret, ndërsa tjetra me sistemin dhe me mekanizmin, pavarësisht se të dyja janë të lidhura.

E para, ne u kërkojmë Kuvendit dhe të gjitha organeve ligjzbatuese për rastin konkret, por edhe për raste të tjera, të krijohet një komision i posaçëm hetimor për të hetuar përfshirjen ose jo të deputetëve, personave që janë pjesë e organeve ligjzbatuese, familjarëve të deputetëve e të tjerë. Pse? Sepse ka akuza që nuk i është përgjigjur akoma askush. Një komision i posaçëm ka të drejtën të hetojë dhe t'u shkojë deri në fund të gjitha akuzave. Nëse nuk vërtetohen, njerëzit duhet të jenë të lumtur që kanë zbatuar ligjin.

E dyta, ne kemi një kërkesë për komisionin tuaj dhe duam që të merrni në shqyrtim të gjitha masat që janë marrë ose jo në lidhje me mbrojtjen e zonjës Xh. M. Bindja jonë është se nuk ka pasur asnjë masë, të paktën nga raportet duket kështu. Përpara se ta quajmë një version zyrtar, pra që nuk është marrë asnjë masë, është mirë që të shikohen dhe të publikohen të dhënat.

E treta, ne duam që të nxisni Prokurorinë e Përgjithshme të hapë hetime të gjera dhe të menjëhershme në lidhje me rastin. Prokuroria dje ka ngarkuar të akuzuarin kryesor, por nuk është vetëm i akuzuari kryesor, pasi e arrestoi për përndjekje. Përndjekja do të thotë që të pëlqen dikush e ndjek, e bezdis e të tjera, por nuk e ka të përfshirë dhunën brenda. Ajo që ne kërkojmë është që ju të punoni nga afër me prokurorinë në mënyrë që ata ta dinë që çdo deputet i këtij Kuvendi do të jetë në krah të tyre për të hetuar çdo person që është përfshirë në ngjarjen në fjalë.

E fundit, kemi një thirrje për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe bashkinë përgjegjëse, të ofrohen urgjentisht shërbimet që ligji i ka caktuar me të drejtë çdo personi që është viktimë e dhunës intime apo në familje, por edhe dhunës në përgjithësi.

Për sa i përket problemit të dytë që ka të bëjë me mekanizmin, siç e thashë, nuk është një çështje e re, të gjithë vijmë nga shoqëria civile dhe kemi një jetë që kontribuojmë, mbase sot është momenti që Kuvendi të vendosë pikat mbi “i”, sepse ne i kemi vendosur tonat.

E para, është mirë të themi që mekanizmat nuk zgjidhin çdo gjë, edhe sikur të ekzistonte mekanizmi në momentin që policia e shtetit mundohet ta mbyll çështjen brendapërbrenda, ai nuk do të marrë vesh asgjë çfarë ka ndodhur. Pse? Sepse nuk ka një kod sjelljeje të punonjësve të policisë për rastet e dhunës ndaj fëmijëve, për rastet e dhunës me bazë familjare, si dhe për denoncimin e krimit, se çfarë duhet të bëjë një punonjës i denjë policie kur përballlet me raste të tilla.

E dyta, nuk ka protokolle zyrtare se çfarë duhet të bëjnë punonjësit e policisë dhe zyrtarë të tjerë në këtë çështje. Ne vëmë re në mënyrë të përsëritur mungesë të përgatitjes së personave që janë në kontakt me dhunën ndaj fëmijëve, dhe ndaj vajzave dhe grave në familje.

Shumica e njerëzve që takojmë janë të punësuar për shkak të bindjeve politike. Doni të bëni diçka? Ndaloni punësimet politike, sepse do të arrini të merrni punonjës sociale, psikologë dhe juristë që janë vërtet të dedikuar për të drejtat e njeriut, jo thjesht se kanë lidhjet dhe vijnë për shkak të një x apo y partie. Po të shkosh në bashki, shumica e stafit janë ose të njëjës ose të tjetrës parti dhe kjo është e patolerueshme.

Ka mungesë të theksuar të mbështetjes së stafeve të shërbimeve sociale, sepse janë shërbime të dorës së dytë. Nuk gjen një kryetar bashkie që në mënyrë serioze të tregojë buxhetin, stafin dhe përpjekjet që mbështet këto shërbime shoqërore.

Po i kthehem pak çështjes së mungesës së buxhetit. Ministrja është këtu, ne kemi pasur një shkëmbim idesh për VKM-në që ka të bëjë me fondin social, i cili do të ngrihet dhe besoj që ka

ardhur edhe në buxhetin e shtetit. Ky fond nuk lejon organizatat që të përfitojnë fonde, sepse është ndërtuar në mënyrë të tillë që të mbështesë ndërmarrjet sociale ose mundësisht, kjo është bindja ime dhe ndoshta gabohem, organizatat fetare. Nuk është e ndërtuar për të mbështetur OJF-të. Ne të gjithëve na kërkohet që të hapim ndërmarrje sociale, nëse duam të përfitojmë fonde nga fondi social, ndërkohë që mbi 80% e shërbimeve ofrohen nga OJF-të.

Ka një problem të madh me bashkitë dhe me kryetarët e bashkive për sa i përket mekanizmit të dhunës, por edhe për çështjen e mbrojtjes së fëmijëve, pra për IMF-të dhe PMF-të. Bashkitë nuk e kanë si detyrim që nga buxheti i tyre x % të buxhetit të shkojë për shërbimet shoqërore. Kjo duhet të jetë me detyrim. Nëse kryetarët e bashkive dhe këshillat bashkiake e kanë me detyrim, nuk kanë ku të shkojnë dhe nuk kursejnë dot nga lekët e qytetarëve. Bashkitë e kanë shumë herë më të lehtë të bëjnë tendera rrugësh dhe investime, ndërsa kur vjen puna, le të themi, për të bërë tendera për shërbime, askush nuk do të merret me shërbime. Automatikisht vajza që është 25 kilometra larg Tiranës, as nga Tirana nuk ka përfituar shërbime, gjë që ligji ia lejon asaj. Pra, nëse nuk ka shërbime në bashkinë e Fushë-Krujës, duhet të shkojë në një qytet tjetër të marrë shërbime.

Të mos harrojmë edhe një gjë, por kërkon kohë, çështja e stereotipeve gjinore. Në të gjithë këtë mesele një ndikim jo të vogël kanë paragjykimet ndaj gjinisë femërore, sepse kjo është e patolerueshme për ne, punonjësit shtetërorë, sidomos pjesa mashkullore, nuk janë të trajnuar për të drejtat e grave dhe të vajzave, sado që janë bërë trajnime. Nëse trajnimet nuk bëhen çdo vit dhe nëse nuk arrihet të kuptohet vlera e atij trajnimit, nuk do të ndryshojë asgjë në bindjen e tyre dhe nuk do të arrijmë të ndryshojmë qasjen e tyre ndaj viktimave.

E thashë edhe në fillim fare, por po e them edhe një herë, të dalë një organizatë dhe të thotë që kam marrë lek nga shteti për shërbimet e grave dhe vajzave, këtë nuk e besoj, sepse sot e kësaj dite, pavarësisht se ofrojmë shërbime falas, me 0 lek, ne nuk i ngarkojmë klientët me pagesa, asnjë nga ne nuk merr fonde për të ofruar shërbime. Kjo do të thotë që kemi nevojë për një ndryshim tërësisht drastik të mentalitetit të mbështetjes së OJF-ve.

Faleminderit!

Englantina Gjermani – Faleminderit, zoti Hazizaj, për sugjerimet konkrete, si edhe për rastin e Kujës dhe të gjitha ato që sugjeruat nga puna që bëni!

Më vjen shumë mirë që adresuat problemin që është në disa plane deri te stereotipet. Të gjithë ne jemi të ndërgjegjshëm që është një problem kaq kompleks që nuk zgjidhet vetëm me

mekanizmin, por duhet të funksionojnë të gjitha hallkat dhe, përveç kësaj, duhet edhe ndërgjegjësimi për të cilin kemi vite që punojmë dhe ende nuk jemi aty ku duhet. Fakti që jemi, juve konkretisht, por edhe unë si kryetare nënkomisioni, pjesë e Këshillit për Barazitë Gjinore, i cili është mekanizmi më i lartë në këtë fushë, tregon që kemi një rol dhe përgjegjësi akoma më të madhe për çdo gjë që thamë, edhe për problematikat që hasim.

Në të gjithë këtë diskutim dhe reagim të opinionit publik, për rastin e vajzës në Krujë, vlerësoj shumë ndjeshmërinë e publikut, të jem e sinqertë, përveç shoqërisë civile. Mendoj që reagim qytetar duhet të ketë për çdo lloj rasti të dhunës në familje apo dhunës ndaj gruas. I gjithë ky reagim qytetar ka mesazhe të forta, pastaj puna e funksionimit të mekanizmave dhe mënyrës se si i bashkërendojmë është sfidë e përbashkët.

Lidhur me sugjerimin konkret që dhatë për komision të posaçëm hetimor, për rastin konkret, është diçka që do ta diskutojmë si nënkomisione. Të dyja nënkomisionet kemi diskutuar paraprakisht se çfarë mund të bëjmë tjetër. Në fakt, dua ta ritheksoj se rezoluta është vërtet shumë përfshirëse, me shumë detyra dhe me shumë përgjegjësi për ne, prandaj, nëse të gjithë funksionet shtetërore, parlamenti dhe shoqëria civile, realizojmë atë që kemi në rezolutë, do të kishim dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm.

Të gjitha problemet që ju ngritët, i kanë ngritur edhe një pjesë e bashkive. Për shembull, mungesën e trajnimit të stafit dhe të buxheteve. Mendoj se kontributi që do të japim, në projektbuxhetin e këtij viti, sidomos inkurajimi i fortë apo kërkesa ndaj çdo njësie vendore për të parashikuar buxhet për shërbime sociale dhe për të përfshirë buxhetin gjinor do të jetë një rezultat konkret.

Fjalën e ka zoti Brajan Williams, i cili është koordinator i përhershëm i Kombeve të Bashkuara.

Brian Williams – E nderuara, zonja kryetare,

Të nderuar deputetë të parlamentit të Shqipërisë,

Të nderuar përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile,

Mirëmëngjesi!

Faleminderit që më ftuat dhe që më lejoni të jem pjesë e kësaj seance dëgjimore, që me të drejtë u është përkushtuar çështjeve sociale!

Më lejoni të vë në pah punën që ka bërë shoqëria dhe qeveria shqiptare në promovimin e të drejtave sociale dhe të them që këto rezultate janë arritur për shkak të partneritetit të fortë mes

qeverisë lokale dhe asaj qendrore, shoqërisë civile, organizatave, parlamentit akademisë e kështu me radhe.

Gjithashtu, dua t'ju përgëzoj për ndryshimet e fundit ligjore. Veprimet e mekanizmit të RKK-së janë shumë të rëndësishme për ndryshimin e mendësisë dhe të qasjes që kemi ndaj këtij fenomeni. Është lajm i mirë që kemi 39 bashki, të cilat e kanë themeluar RKK-në. Tashmë u tha edhe nga disa parafolës që se edhe në disa prej këtyre RKK-ve që janë ngritur tashmë, ka ende punë për të bërë. Nuk ka kryetarë të bashkive aq sa duhet për ta vënë këtë çështje në plan të parë. Nuk ka pjesëtarë të mjaftueshëm të RKK-së, të cilët marrin rolet e tyre përkatëse për të sjellë një ndryshim. Burimet financiare dhe ato njerëzore janë të kufizuara në raport me shërbimet që kërkohen. Ka qarkullim të shpeshtë të personave që janë përfshirë në RKK, gjë e cila ndikon në performancën e tyre. Është e rëndësishme për t'u theksuar dhe më lejoni të përgëzoj qeverinë shqiptare për ngritjen e sistemit elektronik të ndjekjes së këtyre rasteve. Është diçka tepër e rëndësishme të kemi të dhëna të mira dhe të besueshme. Në këtë mënyrë ne mund t'i mbajmë përgjegjëse institucionet përkatëse. Nga sistemi rival ne e shikojmë se po shënohet një përparim pozitiv. Për shembull në vitin 2017 ne kemi vënë re se kishte 718 raste të dhunës familjare, të dokumentuara. Ndërkohë 2 vjet më parë në vitin 2015 kishte vetëm 545 raste të dhunës familjare të dokumentuara. Kjo thekson problemin, sepse faktikisht sa më tepër efikase të bëhen institucionet, aq më tepër çështjet do të dalin në sipërfaqe. Ky është edhe një lajm i mirë, sepse tregon që ndihen më tepër gra të sigurta, aq të sigurta sa të paraqesin shqetësimet e tyre.

Për sa i përket të ardhmes është e rëndësishme që të gjitha bashkitë e Shqipërisë të kenë të themeluar RKK-në, të kenë burimet e nevojshme për të ofruar shërbime të rrafshit multidisiplinar, të cilat parafolësit i kanë përmendur sot dhe t'u kushtojnë vëmendje, veçanërisht grave në pozita të cenueshme, kam në mendje veçanërisht gratë nëpër zonat rurale, që janë viktimë e trafikimeve, gratë me aftësi të kufizuara, gratë rome dhe egjiptiane.

Unë dua ta mbyll me një ose dy shënime të tjera, të cilat janë të karakterit të përgjithshëm. Një koment kam për mbështetjen nga Kombet e Bashkuara për shoqërinë civile, diçka që u përmend pak më parë. Shteti duhet të ofrojë mbështetje për shoqërinë civile, sepse në këtë mënyrë mund të përfitojë prej pikave të tyre të forta siç është, për shembull kontakti i vazhdueshëm që ato kanë me shoqërinë dhe grupet specifike.

Kam një koment tjetër të përgjithshëm për alokimin e buxhetit të shtetit dhe burimeve të tjera shtetërore. Në fillim të këtij viti ne nxorëm një raport, në të cilin shikon çështjen e

përshpejtimin dhe të realizimit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Ky raport hedh dritë për shpenzimet për sa i përket mbrojtës sociale. Qeveria shqiptare shpenzon rreth 12% të shpenzimit të brendshëm bruto për çështjet sociale.

Në krahasim me vendet e tjera të rajonit, ky shpenzim nga qeveria shqiptare është sa gjysma e tyre ose pak më pak sesa aq. Shtimi i përqindjes së GDP-së për çështjet e mbrojtjes sociale kërkon një prioritizim më të lartë të këtyre çështjeve dhe shtimin nga ana e qeverisë të të ardhurave, në radhë të parë.

Pika e tretë ka të bëjë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo çështjet lidhet ngushtë me objektivin nr. 5 të zhvillimit të qëndrueshëm që ka të bëjë me barazinë gjinore. Ka të bëjë gjithashtu me objektivin nr.16 të zhvillimit të qëndrueshëm, me shtetin e së drejtës dhe me gjyqësorin. Objektivi nr.16 i zhvillimit të qëndrueshëm thotë specifikisht: “Drejtësi për të gjithë, jo drejtësi për një pjesë ose për disa të veçantë”. Drejtësia është për të gjithë. Kjo e bën të qartë që gjysma e popullsisë së Shqipërisë faktikisht ka ndjesinë e të qenit e sigurt. Nëse RKK-të e kryejnë funksionin e tyre ashtu siç duhet, rastet tragjike siç ishte rasti i fundjavës së kaluar në Krujë, mund të ishin parandaluar, fillimisht. Tani që ky rast ka ndodhur, ai kërkon një hetim të plotë dhe të shpejtë në mënyrë që drejtësia të vihet në vend.

Ju kërkoj ndjesë, zonja kryetare që mora kaq shumë kohë!

Eglantina Gjermeni - Shumë faleminderit, zoti Williams për angazhimin, kontributin tuaj dhe të UNDP-së, si edhe për sugjerimet konkrete për qeverinë, parlamentin dhe nënkomisionin!

Vlerësoj faktin e citimit të rastit të fundit që ndodhi, vajza me iniciale XH. M nga Kruja. Me thënë të drejtën shpreh keqardhjen se sot që diskutohet mekanizmi i dhunës, ai duhet përforcuar, siç biem dakord të gjithë për të parandaluar këto raste, deputetët e opozitës nuk i kemi këtu. Mendoj se politika është diçka që të gjithë ne që jemi pjesë e saj e kuptojmë, e besojmë, duam të sjellim ndryshim, por kur vjen puna për rastin e dhunës në familje, ashtu siç ishim kur miratuar rezolutën, mendoj se duhet të jemi bashkë një zë, sepse kështu japim një model shumë më të mirë, edhe për të parandaluar dhunën, edhe për të trajtuar rastet që mekanizmi të funksionojë dhe të ketë më shumë siguri për viktimën dhe mirëqenien e saj.

Vazhdojmë me qendrën Aleanca Gjinore për Zhvillim, zonja Mirela Arqimandriti.

Mirela Arqimandriti – Përshëndetje të gjithëve!

Nuk do t’ju mbaj shumë, sepse shumicën e gjërave e dëgjuat, duke respektuar të gjithë kolegët e mi që punojnë, si edhe unë edhe organizata ime në teren nxorën shumë problematika

përpara. Ne kemi bërë monitorimin e qëllimit të së drejtës së Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016- 2020 për funksionimin e mekanizmit të referimit kundër dhunës në familje dhe disa gjëra të tjera që lidhen me materialet promovuese, ndërgjegjësimin, si edhe me çështjen e trajtimit të dhunuesve në 6 bashki të Shqipërisë: në Tiranë, në Shkodër, Durrës, Vlorë, Elbasan dhe Korçë. Jo pa qëllim zgjodhëm këto bashki, pasi janë bashki ku mekanizmi është krijuar prej shumë vjetësh. Me thënë të vërtetën një fjali dua të them që ta përmbledh: mekanizmi i referimit në të 6-ta këto bashki është një mekanizëm pak a shumë i leqendisur, në kuptimin që mezi mbahet në këmbë. Mbahet në këmbë nga një punonjëse e bashkisë, e cila ka edhe qindra detyra të tjera mbi kurriz dhe shpesh nuk i del fare koha të merret, disa prej tyre janë edhe sekretare të kryetarëve të bashkive. Policia është ajo në nivel bashkie, e cila merr së pari të gjitha raportimet për dhunën në familje, e cila në të 6-ta bashkitë që pamë për vitin 2017 (po shikojmë vitet 2017-2018 dhe 2019) ka qenë në rang bashkie diku te 400-500 raste të raportimeve të dhunës në familje, kurse bashkitë përmes mekanizmit të tyre të referimit kanë trajtuar jo më shumë se 10 raste brenda këtij viti. Pra, as 10% pak a shumë të atyre që raportojnë. Fati i këtyre grave qoftë edhe atyre që kanë kaluar përmes mekanizmit është i paditur, sepse nuk ndiqet në vazhdim. Problemi kryesor mbeten financat. Bashkitë harxhojnë shumë para për 100 gjëra të tjera, por ndërkohë për çështjet sociale brenda bashkisë dhe për mekanizmin nuk harxhojnë asnjë lekë. Nuk ka asnjë nga këto bashki që të ketë harxhuar një lek për materiale promovuese apo për aktivitete ndërgjegjësuere kundër dhunës në familje. E dimë se pjesë e mekanizmit janë edhe institucionet shëndetësore dhe arsimore, të cilat janë zero, në bashkëveprimin në lidhje me mekanizmin kundër dhunës në familje. Madje shërbimet shëndetësore edhe më tej në asnjë nga qendrat shëndetësore të këtyre bashkive nuk pamë të varur një informacion në lidhje me dhunën në familje. Të vetmet që bëjnë aktivitete në nivel vendor janë organizatat e shoqërisë civile, ku merr pjesë edhe bashkia, kryetari i saj e të tjera në nivel të lartë. Pra, këto ishin gjërat kryesore që ne pamë. Ne kemi përgatitur të 6 raportet. Unë i kam sjellë këtu dhe një nga punonjësit e Kuvendit mund t'i shpërndajë gjetjet dhe rekomandimet për të 6 bashkitë, të përmbledhura. Me *e-mail* do t'ju dërgoj raportet përkatëse, si ju edhe të tjerëve. Ajo që është më e rëndësishme, në të gjitha këto bashki janë bërë 1-2 ose zero mbledhje të mekanizmit të referimit gjatë vitit 2017 dhe asnjë mbledhje e komitetit drejtues, për fat të keq, ku duhet të marrë pjesë kryetari i bashkisë, kryetari i gjykatës e të tjerë, sepse këta zotërinj e quajnë dhunën në familje si një çështje, e cila nuk u takon atyre, por i takon një punonjëseje të thjeshtë në bashki,

e cila nuk mundet dot ta kryejë këtë gjë, është e pafuqishme, sepse për çdo gjë duhet të marrë urdhër dhe mbështetje nga kryetari, i cili zakonisht nuk e jep, me sa kuptuam.

Atëherë, çfarë mund të bëni ju? Buxhetimi gjinor është i domosdoshëm. Ne jemi mbledhur shpeshherë në këtë sallë për çështjet e dhunës në familje. Të paktën, një herë në vit ne vijmë këtu dhe flasim për çështjet e dhunës në familje. Buxhetimi për çështjet e dhunës në familje është jashtëzakonisht i dobët. Vetëm dy bashki japin 4 mijë dollarë maksimumi për dy organizata të shoqërisë civile, bashkia e Durrësit dhe bashkia e Vlorës, përfshi edhe bashkinë e Tiranës, ndërkohë që ato janë vetëm për pagën e punonjësit, i cili nuk ka para të tjera që të ndërveprojë, përfshi transportin për të ndihmuar viktimën, përfshi telefonat e të tjera. Pra, çdo gjë bëhet me të ardhura personale.

Për mendimin tonë ju duhet të bëni një plan veprimi për mekanizmat e dhunës në familje në nivel bashkie, pra të personalizuar sipas bashkive. Nuk mund të bëhet një gjë e përgjithshme, por duhet t'u kërkonti bashkive një plan veprimi të personalizuar me buxhetin përkatës. Çfarë duan ata që kjo gjë të funksionojë dhe në qoftë se nuk arrihet dot në këtë buxhet për të gjitha bashkitë, të bëhet një pilotim në vitin e ardhshëm.

Të rritet pagesa e ndihmës ekonomike, sepse është jashtëzakonisht qesharake dhe nuk mundet që gratë e dhunuara të mbyllin të gjitha hallet që kanë me 30 mijë lekë të vjetra, përpos gjërave të tjera që përjetojnë.

Të krijohet një protokoll i trajtimit të rasteve, sepse ne nuk gjetëm asnjë të dhënë për rastet e vitit 2017, pra të krijohet një protokoll midis bashkisë dhe policisë se si të trajtohen rastet. Domethënë, u mor rasti MA me fëmijët e vet, po çfarë ndodhi me këtë rast, ku po shkon, çfarë po bëhet dhe gjithçka tjetër.

Nuk ka asnjë të dhënë, përveç se disa shënimeve që shpeshherë edhe në mbledhje nuk mbahen.

Ndoshta ju duhet të krijoni një task-forcë, siç është krijuar në rastet e tjera. Ju jeni deputete dhe shkoni në zonat tuaja dhe ndoshta duhet të krijoni një taskë-forcë për të monitoruar disa nga këto bashki ose për të folur me kryetarët përkatës. Mua më vjen keq që zonjat dhe zotërinjtë e PD-së nuk janë sot në këtë takim, sepse kjo është një çështje mbarëkombëtare, nuk është një çështje vetëm e PS-së dhe është gjynah që ne flasim, por ndërkohë nuk na dëgjon e gjithë sfera politike, e cila është vendimmarrëse.

Fushata është shumë e rëndësishme. Zonja Blerina Gjylameti e përmendi pak më parë, që fushata duhet të ketë fonde të mjaftueshme, të posaçme dhe duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme.

Pak a shumë këto janë gjërat që ne kemi, të cilat do t'ua sjellin edhe me shkrim, me gjetjet dhe rekomandimet, me gjërat specifike sipas bashkive, por unë gjithmonë synoj, meqenëse mekanizmi është në nivel bashkie, duhet të jetë i personalizuar sipas bashkive.

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Arqimandriti për monitorimin dhe për ndarjen e informacionit!

Të dhënat që ju sapo referuat janë shumë shqetësuese për të gjitha bashkitë që ju keni monitoruar dhe, të them të drejtën, të gjithë ne aktorëve që po flasim për dhunën na vë para një përgjegjësie shumë të madhe. Më vjen keq të dëgjoj që nuk janë bërë mbledhje, se mungesa e fondeve dihet se është një shqetësim, por që nuk janë mbledhur apo nuk janë trajtuar rastet, ndërkohë që flasim për mekanizma referimi deri diku të konsoliduara në këto bashki të cilave u referohemi.

Faleminderit edhe për sugjerimet për nënkomisionin dhe për të gjithë deputetët! Unë mendoj se jemi apo s'jemi pjesë e nënkomisionit, në momentin që jemi deputetë, një detyrë ekstra dhe shumë të rëndësishme që mund të kemi në zonat që ne dalim si deputetë, në zonat ku votohemi, përveç problematikave të tjera që ndjekim që janë, në fakt, të shumta, kjo të trajtohet si një çështje prioritare dhe të jemi pranë kryetarëve të bashkive, po sidomos theksoj rolin më të madh që duhet të marrin edhe këshillat bashkiake.

Ne bashkë kemi kaluar ndryshime ligjore që 50% e anëtarëve të këshillave bashkiake janë gra. Në qoftë se nuk ka mekanizma të referimit të dhunës, edhe këshilltarët bashkiakë, gra dhe burra, mund të jenë shumë mira aleatët tanë dhe të na mbështesin për ta krijuar dhe për ta forcuar mekanizmin kundër dhunës.

Ne, pa dyshim, do të dalim me një vendimmarrje si nënkomision edhe për hapat më tej, përveç planit të veprimit, që në fakt e kemi miratuar dhe në bazë të këtij plani jemi sot këtu. Gjithsesi, lidhur me mekanizmin dhe mënyrën e funksionimit të tij dhe ushtrimin e presionit të vazhdueshëm ndaj njërive vendore për t'i krijuar dhe për t'i përforcuar mekanizmat ekzistues dhe për t'i krijuar aty ku nuk janë, do të jetë i vazhdueshëm, edhe me vizita në terren, edhe me monitorim konkret nga nënkomisioni, pse jo edhe nga Aleanca e Grave Deputete.

Vazhdojmë me përfaqësues nga rrjeti i qendrave komunitare.

Urdhëroni, zonja Migena Ismailati!

Migena Ismailati - Faleminderit!

Pjesa më e madhe e problematikave dhe rekomandimeve u dhanë nga OJF-të e tjera.

Ne jemi një qendër komunitare, pjesë e mekanizmit të referimit në bashkinë Durrës dhe Tiranë. Po flas në nivel teknik, aty ku ne hasim probleme. Meqenëse u fol që koordinimi i aktorëve të grupit teknik nuk është gjithmonë efikas ose nuk është i fortë, atëherë duhet të jenë mbledhjet e komitetit drejtues më të shpeshta.

Duke pasur një angazhim nga drejtuesit e institucioneve përgjegjëse, atëherë edhe grupi teknik do të jetë më i përgjegjshëm.

Unë e kam merakun te prokuroria. Kemi raste shumë të dhimbshme grash, të cilat, edhe pse kanë marrë urdhër mbrojtjeje, nuk ka asnjë informacion për procedimin penal, as vetë viktimat nuk ka informacion, as ne si organizata që ofrojmë shërbimin nuk na jepet informacion, sepse janë nën hetim, por kjo na cenon shumë në punën e përditshme, sepse dhunuesi është i lirë.

Ligji i ri është shumë i mirë, por ka nevojë për përmirësime të tjera. Aty janë përfshirë programet për rehabilitimin e dhunuesve.

Javën e kaluar kishim një rast në Durrës, ku grupi teknik i mekanizmit funksionoi, por dhunuesi me probleme të shëndetit mendor nuk kishte ku të shkonte dhe mbeti i lirë, atëherë morëm dhe strehuam vajzat në Tiranë. Kjo nuk është zgjidhje që bën për të gjitha rastet.

Ne kemi edhe një qendër në Pukë, por nuk mjafton vetëm një koordinator vendor, sepse me dëshirën e madhe, pasionin dhe vullnetin dhe gjithë kontributin që mund të ketë, në qoftë se nuk ka angazhimin e të gjitha institucioneve të tjera, atëherë nuk mund të punojmë. Prandaj doja të theksoja që mbledhjet e komitetit drejtues, angazhimi i këtyre forcon bashkëpunimin, pastaj edhe trajnimi i anëtarëve të mekanizmit të referimit të jetë i vazhdueshëm.

Doja të theksoja edhe ndihmën juridike falas. Kjo nuk aksesohet nga gratë rurale. Gjithashtu, ashtu siç ngritur ndihma juridike falas, të ngrihet edhe ndihma psiko-sociale falas, pra t'i ofrohem menjëherë viktimës shërbimet e jo të vardiset nga njëra zyrë të tjetra për të marrë shërbimet bazike, duhet të jenë *one-stop-shop*.

Në të gjitha vendimet e urdhrave të mbrojtjes që ne shohim thuhet se shkon edhe te shërbimi social. Momentalisht ne kemi një shërbim social me numër të pakët punonjësish, të cilët nuk kanë fokusin, ose e kanë shumë të vogël, te viktimat e dhunës me bazë gjinore apo në familje.

Gratë që janë me urdhër-mbrojtjeje, duke përjashtuar urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes, nuk arrijnë ta përfitojnë atë ndihmë dhe shërbimi social nuk është vetëm ndihma që u jepet, ajo

pagesa e ulët, por është edhe te monitorimi i urdhrave të mbrojtjes. Ne këtë e kemi merak, sepse nuk e kemi hasur. Kjo bëhet nga OJF-të, por jo nga personat përgjegjës shtetërorë.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, edhe për punën që bëni, edhe për sugjerimet tuaja!

Doja të sqaroja diçka. Sa i përket dhunës në familje, me gjithë dimensionet që ka, asnjëri nuk do t'ia dalë i vetëm, kështu që unë nuk e shoh përgjegjësinë të ndarë, “ne si OJF e bëmë këtë, kurse shteti s’po bën këtë” e të tjera. A ka mundësi që t’i bëjmë të gjithë bashkë? Besoj se shoqëria civile këtë rol ka, ajo është mes nesh dhe qytetarëve pikërisht për të dhënë këtë kontribut kaq të vlefshëm dhe falë këtij kontributi jemi sot këtu.

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Në fakt, doja të ndërhyja pak në lidhje me shqetësimin që e përmendën disa prej jush, por e kam ndeshur shumë në rrjetet sociale, por nuk kam dashur të debatoja.

Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale në mars të vitit 2017 kanë caktuar prokurorin, koordinatorin e viktimës në çdo prokurori, falë edhe mbështetjes së ambasadës të SHBA-së. E para.

E dyta, është kërkuar që shërbimet të jenë proaktive, pra prokurorët nuk mund të adresojnë çështjet (nuk dua të mbroj prokurorët), sepse OJF-të duhet të akreditohen, të krijohet një regjistër.

Zoti Azizaj ka bërë një koment te ligji i dhunës në familje, por ne nuk e reflektuam me detaje, sepse e kishim reflektuar në Kodin e Procedurës Penale. Pra, në Tiranë, a kemi një regjistër të organizatave që ofrojnë shërbime, apo kemi më shumë organizata që monitorojnë, sesa ofrojnë shërbime?

Ky regjistër duhet t’u vihet në dispozicion Ministrisë së Drejtësisë, prokurorive dhe policisë.

E treta, është ndihma juridike. Kjo është një ndihmë komplekse, pra nuk është thjesht ndihmë juridike. Kemi futur edhe ndihmën sociale, edhe psikologjike, edhe mjekësore dhe të gjitha shërbimet janë falas. Këtë e diskutuam edhe te grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, por bashkë me ndërhyrjen që ka bërë zonja Bushka dhe zoti Fino te ligji për përjashtimin nga taksat dhe nga shpenzimet, hyn gjithçka brenda.

E fundit, do të sugjeroja, zonja Gjermeni, që një seancë dëgjimore të jetë me Urdhrin e Psikologut dhe për Urdhrin e Punonjësit Social. Kemi bërë ligje, kemi bërë ndryshime dhe nuk

dimë çfarë po ndodh. Nëse ata nuk akreditohen, nuk regjistrohen në bazë të ligjit, pra nuk ofrojnë shërbime. Ne kështu do të mblidhemi edhe pas dy javësh apo tri javësh. Ligjet janë tashmë të kompletuara, por rëndësi ka që këto mekanizma të përdoren dhe unë do t'ju sugjeroja të vëmë në eficiencë koordinatorin që është ngritur në çdo prokurori, i cili koordinon me shoqërinë civile.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Hysi!

Altin Hazizaj – Vasilika ka shumë të drejtë kur liston ato që janë bërë, por në nivelin praktik nuk ndodhin gjërat. Kthehemi te problemi i vjetër, që është zbatimi i ligjit. Ky është një problem shumë i madh.

E dyta, para se t'u kërkojmë rezultatet zyrtarëve të bashkisë që merren me mbrojtjen e grave, mbrojtjen e fëmijëve, se janë bërë pjesë e një sistemi tani, ligji i ri i shërbimit shoqëror i ka futur të gjithë brenda një drejtorie, departamenti, apo si të duan ta quajnë; në qoftë se nuk fuqizohet ky departament në bashki, dhe bashkitë nuk e kanë për detyrë të japin, le të themi, 30% të buxhetit që bashkia menaxhon, ata nuk mund të bëjnë asgjë.

Ne i themi bashkisë: ofro shërbim për fëmijët! Bashkia thotë: unë ofroj shërbim për fëmijët, sepse kam një person që merret me mbrojtjen e fëmijëve. Ai është administrator shërbimi, nuk është ofruer shërbimi. Ligji e ka bërë të qartë që... jo të licencohen, as të akreditohen, sepse ne e marrim licencën nga ministria, por termi është: të kontraktohen OJF-të, ndërmarrjet sociale, për të ofruar këtë gjë. Në qoftë se nuk ka fonde, ai nuk ka çfarë bën.

Pra, në qoftë se ka diçka që duhet zgjidhur, është ngërçi i mbështetjes financiare të shërbimit. Ju kërkoj shumë ndjesë, por meqë jemi këtu, bashkitë e marrin udhëzimin nga Ministria e Financave, se çfarë ato duhet të programojnë në buxhetin e tyre. Në qoftë se ai ligj nuk ndryshon, është e kotë që flasim për financim shërbimesh. Ai është ligji që ne duhet të ndryshojmë, që metodologjia ta ketë të caktuar, që kaq për qind e buxhetit, po them minimumi, jo maksimumi, do të shkojë për këtë qëllim. Po u zgjidh ky ngërç, bashkia nuk do t'i mbajë lekët për qejfin e vet, por do të jetë e detyruar t'i shpërndajë.

Eglantina Gjermeni – Faleminderit!

Meqenëse kemi disa kolegë, që kanë ngelur për t'u prezantuar. Sigurisht, duke dhënë sugjerimet konkrete edhe nga përvoja juaj. Jo përsëritje. Do ta vlerësoja shumë nëse do të ishim më efikasë. Më vjen keq që disave u takon radha më vonë, por ne do t'ju dëgjojmë të gjithëve, kjo është e sigurtë.

Nga linja e këshillimit për gra dhe vajza, kemi ndokënd? A do të flasë dikush? Jo.

Nga shoqata “Gruaja te gruaja”, Shkodër, kemi ndokënd? Jo. këto janë, që kanë konfirmuar. Qendra “Vatra”, Vlorë. Zonja Puka?

Zonja Mariana Meshi, qendra “Të ndryshëm, por të barabartë”, fjala për ju.

Mariana Meshi – Përshëndetje të gjithëve! Faleminderit për mundësinë!

Në fakt, edhe kolegët i përmendën goxha, kështu që unë do të mundohem që kryesisht të ngre ca çështje nga praktika, të cilat kanë të bëjnë qoftë me profesionalizmin e strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e të mbijetuarave të dhunës, qoftë me koordinimin, me infrastrukturën dhe burimet financiare.

Dëshiroj ta nis te pjesa e informimit të viktimave të dhunës, për të drejtat e tyre dhe për shërbimet. Jo vetëm rasti i fundit, por shumë raste rezultojnë që, kur viktimat bien në kontakt me strukturat e zbatimit të ligjit, nuk informojnë, ose informojnë në mënyrë shumë të cunguar. Edhe me ndryshimet e fundit në Kodin e Procedurës Penale, ajo çfarë ne kemi konstatuar është që, duke qenë se tani janë të detyruar ta bëjnë edhe të nënshkruar, thjesht printojnë të drejtat nga kompjuteri, ashtu siç janë në kod, dhe ua japin viktimave, të cilat nuk i kuptojnë fare. Ne jemi përballur me raste nga praktika, kur për shkak të mosinformimit ka edhe barriera për të pasur akses në shërbime, për t’u referuar më tej në shërbime.

Në fakt, edhe rasti i fundit dëshmon se ka mungesë informimi për të drejtat, për shërbimet, për mundësitë, për sigurinë, për të gjitha aspektet, përveç gjithë problematikave të tjera.

Pjesa e referimit në shërbime, që në fakt u përmend, arsye për të cilën nuk po e zgjas. Diçka që nuk para u përmend shumë, është se mekanizmat, edhe kur ngrihen nuk është se funksionojnë në të njëjtin nivel, por edhe strukturat e përfshira aty dhe kanë funksione, nuk është se funksionojnë njëllë. Unë dua të përmend disa nga ato, siç është përmbartimi. Meqenëse nuk u përmend nga kolegët, dua at sjell. Ka pasur probleme për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, si ato që kanë të bëjnë me detyrimin ushqimore. Në fakt, ne “Rrjeti për monitorimin e dhunës me bazë gjinore” e kemi ngritur këtë, edhe me propozime konkrete, takimet me prindërit, çështjet e kujdestarisë, përpjesëtimi i pasurisë, si dhe pasoja të tjera, të cilat rrjedhin nga martesat.

Në fakt, shohim se të gjithë mekanizmat janë shumë jo aktivë, si përmbartimi, dhe ne si përfaqësues institucioni e kemi të vështirë t’i takojmë ne, jo më vetë viktimat. Kështu që, ky ngelet problem shumë i madh. Në lidhje me pjesën e shërbimeve folën edhe kolegët. Në lidhje me pjesën profesionale, në fakt, do të doja ta theksoja edhe një herë qasjen proaktive ndaj viktimave, si dhe

pjesën e të trajtuarit të tyre me ndjeshmëri, sepse shumë nga rastet kur kanë pësuar dhunë janë ndjerë jo të trajtuara siç duhet nga ana profesionale.

Do të doja të përmendja çështjen e besueshmërisë të publiku. Në fakt, kjo gjë duket edhe në rastet që ne kemi trajtuar. Në shumë raste mungon besimi, sidomos besimi të institucionet e zbatimit të ligjit. Ato ndjehen nën presionin e dhunuesve, prandaj, për shkak të kërcënimeve që kanë dhe për shkak të mungesës së besimit të institucionet e zbatimit të ligjit, në shumë raste ndodhin edhe tërheqje nga denoncimet apo kërkimi i të drejtave të tyre.

Për sa i përket aksesit në shërbime, në fakt, përveç zhvillimit të shërbimeve aty ku mungojnë, unë do të doja edhe lehtësimin e procedurave për t'u aksesuar shërbimet, sepse sistemi kërkon shumë burokraci, shumë letra, por edhe shpenzime, që për viktimat e dhunës është shumë e vështirë t'i aksesojnë.

Çështjen e protokollit e përmendën edhe kolegët. Unë insistoj se nga praktikrat, por edhe nga diskutimet me profesionistët që punojnë në terren, mekanizmi është shumë mirë, por hartimi i një protokollit me përgjegjësi të detajuara duhet të jetë, në mënyrë që të dihet se çfarë, kush dhe si. Përveç të tjerave, duhet edhe pjesa e monitorimit të zbatimit të përgjegjësive specifike që ka secili institucion dhe secili profesionist. Po nuk i monitoruam, sistemi do të na çalojë patjetër, sidomos në nivel mendor.

Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zonja Meshi, edhe për punën tuaj, edhe për sugjerimet konkrete!

Besoj se “Qendra për të drejtat e njeriut në demokraci nuk e shikoj”, ndoshta ngaqë e kam me emër tjetër.

Lindita Cakoni – Lindita Cakoni.

Eglantina Gjermani – Të lutem, Lindita!

Lindita Cakoni – Faleminderit për mundësinë që po na jepni, që të ndajmë nga ju disa nga konstatimet tona në lidhje me çështjen objekt diskutimi. Unë vi nga një organizatë, e cila ofron shërbime ligjore pa pagesë për të mbijetuarat nga dhuna në familje e dhuna me bazë gjinore. Gjithashtu, ne kemi punuar edhe në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të punonjësve të institucioneve përgjegjëse, në kuadër të zbatimit të legjislacionit kundër dhunës në familje.

Gjithashtu, së fundmi, qendra jonë dha një kontribut të rëndësishëm sa i përket amendimit të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Aktualisht, qendra jonë është pjesë e mekanizmit të referimit të rasteve të dhunës në familje në bashkinë e Tiranës, dhe po mbështet funksionimin e mekanizmit të referimit në bashkitë Kamëz dhe Tropojë.

Në fakt, trajtimi multidisiplinar i rasteve të dhunës në familje përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të situatës së viktimave të dhunës dhe i shërben mbrojtjes së integritetit të tyre. Nga monitorimi i vendimeve të gjykatës të rrethit gjyqësor Tiranë për vitet 2016 e 2017, na rezulton se janë shqyrtuar 1928 kërkesë-padi dhe janë lëshuar 484 urdhra mbrojtjeje.

Nisur nga numri i lartë i rasteve dhe fakti se numri më i madh i këtyre rasteve ka nevojë për mbështetje të koordinuar, trajtimi multidisiplinar i këtyre rasteve paraqet domosdoshmëri.

Nga praktika na rezulton se është shumë e vështirë që një numër kaq i madh rastesh të koordinohet nga një koordinator vendor në rang bashkie. Nuk e di sa e mundur do të ishte, por ne si organizatë e vlerësojmë me vend që në nivel njësie administrative të ketë punonjës gjinorë, një koordinator i cili të ndjekë çështjet e dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore, dhe më pas ta koordinojë veprimtarinë e tij me mekanizmin e referimit në bashkinë përkatëse ku operon njësi administrative.

Një tjetër problematikë e konstatuar ka të bëjë me numrin e limituar të rasteve që janë trajtuar nga mekanizmat e referimit që përmenda pak më sipër. Pra, mund të themi se vetëm një numër minimal rastesh arrin të trajtohet nga këto mekanizma dhe të marrë shërbimet mbështetëse që ofrohen për këtë kategori.

Sa i përket mënyrës së funksionimit të mekanizmave të referimit, kemi konstatuar se disa nga institucionet përgjegjëse nuk janë pjesë aktive, siç u tha edhe nga parafolësi. Në mënyrë të veçantë duhet të rritet roli dhe kontributi i institucioneve shëndetësore, të cilat në bazë të legjislacionit në fuqi kanë një sërë detyrimesh për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

Një tjetër problematikë e konstatuar nga ana jonë ka të bëjë me numrin e ulët të rasteve që kanë përfituar nga shërbimi ligjor falas, i ofruar nga shteti. Nga monitorimi në tre vitet e fundit i vendimeve të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, na rezulton se është një numër ndoshta i papërfillshëm numri i personave që kanë përfituar nga këto lloj shërbimesh. Në këtë kuadër, nevojitet që zyrat e ndihmës ligjore falas, të ofruara nga shteti, të jenë pjesë aktive e mekanizmave të referimit, me qëllim që të rritet numri i rasteve të mbështetura nga këto zyra.

Në fakt, Konventa e Këshillit të Europës, përveç dhunës në familje, ka parashikuar edhe forma të tjera të dhunës ndaj grave, siç janë dhuna seksuale, përndjekja, martesat e detyruara apo

aborti i detyruar, dhe ne si organizatë sugjerojmë që edhe këto forma dhune të jenë objekt i menaxhimit nga mekanizmat e referimit në bashkitë përkatëse.

Gjithashtu, nga praktika kemi konstatuar se me gjithë përpjekjet e bëra nga koordinatorët vendorë dhe ETN-të, për adresimin e nevojave të rasteve konkrete, jo gjithmonë viktimat e dhunës kanë përfituar nga shërbimet mbështetëse.

Shërbimet janë ato që janë. Ne shpresojmë të rriten në numër e në cilësi, por sugjerojmë të merren masa për koordinim më të mirë të këtyre shërbimeve që janë aktualisht, si dhe të monitorohet ofrimi i tyre nga institucionet përkatëse.

Ju faleminderit!

Eglantina Gjermeni – faleminderit edhe për punën, edhe për prezantimin!

Do të doja vetëm të theksoja çështjen që ju ngritët për rekomandimin e GREVIO-s, lidhur me format e tjera të dhunës. Më vjen shumë mirë, e kemi diskutuar, është një nga rekomandimet më të forta. Ministria po punon për një ligj, që t'i trajtojë të gjitha format e dhunës ndaj grave. Është një angazhim madhor, që besoj se do të ndikojë fuqishëm në parandalimin dhe trajtimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave.

Folësja tjetër është zonja Hajdarmataj, qendra “Gratë në shërbim publik”.

Ju lutem, shkurtimisht.

Faleminderit!

Mimoza Hajdarmataj – Faleminderit edhe juve!

Në fakt, unë e kisha përgatitur fjalën, por u shteruan pothuajse të gjitha çështjet. Unë përfaqësoj qendrën “Gratë në shërbim publik”. Kjo është një organizatë relativisht e re. Ndjehemi të nderuara që jemi bërë edhe ne pjesë e rrjetit kombëtar të organizatave për monitorimin e dhunës, që të mund të japim edhe ne kontributin tonë modest. Si organizatë, jemi të përqendruara e të fokusuara në fuqizimin e grave e të vajzave nëpërmjet edukimit.

Në fakt, unë po citoj vetëm pjesën e fuqizimit nëpërmjet edukimit, por në kuadrin e veprimtarisë sonë, së bashku me koleget e tjera, kemi konstatuar, dhe besoj të gjithë e ndajmë si mendim, se ekziston një mentalitet, që dhuna, sidomos dhuna në familje, duhet të jetë një fenomen që ndodh me dyer të mbyllura, diçka që është private, familjare.

Kjo mundëson një terren për të gjitha organizatat, për të ngritur një fushatë kombëtare në lidhje me ndërgjegjësimin e grave dhe vajzave, që ta denoncojnë dhunën, edhe kur ajo ndodh në kushte private, siç mund ta konsiderojnë.

Shqetësimi vjen, duke qenë se realisht u përmendën disa shifra, diku te 30 % të rasteve kur denoncohet dhuna në familje, por ne jemi të shqetësuar edhe për një shifër tjetër: që kemi 12 % rritje të rasteve të dhunës me pasoja vdekjen.

Pra, në qoftë se ne po ngremë një fushatë kombëtare në lidhje me ndërgjegjësimin për denoncimin, ku jemi me mekanizmin e referimit? Ato gra e vajza duhet të jenë të sigurta se nuk do të cedojë ashtu siç cedi në rastin e fundit të zonjushës XH. M., kur ra i gjithë mekanizmi i referimit. Pra, askush nuk po jep llogari se kush është përgjegjës për faktin që nuk është mbrojtur as pas katër denoncimeve në katër komisariate të ndryshme.

Përtej kësaj, gjëja më e rëndësishme është fuqizimi i mekanizmit të mbrojtjes. Kemi shumë pak raste kur strehohen gratë e dhunuara, por kemi raste të shumta kur gratë rikthehen të bashkëjetojnë sërish me dhunuesin, për shkak të mungesës së disa fondeve që bashkitë, ministritë apo shteti, nuk i kanë. Pjesa e mbrojtjes finale, është shumë e rëndësishme që ne të mos e kemi statistikën e ridhunimit deri në pasoja me humbjen e jetës së viktimave.

Dua të shtoj një gjë të re, ndoshta krahasuar me ato që të bëhen pjesë e referimit dhe pjesës së një dhune të padenoncuar më përpara rastet e vetëvrasjeve ose tentativat e vetëvrasjeve, pasi kemi shumë gra, ku duke prezumuar së brendshmi dhunën, shëndeti i tyre mendor është aq i rënduar saqë ato shkojnë deri në tentativë vetëvrasjeje apo vetëvrasje.

Të shtohet në pjesë, jo vetëm të një dhune që ka ndodhur dhe është denoncuar, por që ka arritur derisa është bërë fli.

Për sa i takon AMA-s, besoj se duhet të jetë një institucion që vepron me shpejtësi për të penalizuar me gjobë të gjitha mediet, sepse ndaj grave po ndodh edhe një dhunë verbale, që nga përmendja e të gjitha gjeneraliteteve ose e familjarëve, madje shohim gazetarë të cilët, për hir të lajmit, rendin të kapin deri edhe kushërinjtë e tretë ose të katërt, për të mos thënë edhe gjyshin dhe gjyshen, në mungesë të mospasjes së një lajmi se çfarë i ka ndodhur viktimës, çfarë do të bëjë ajo, si i ka ardhur... Pra, të gjitha këto duhet të jenë pjesë e mekanizmit të referimit apo të rregullimit të të gjithë kësaj gjëje.

Unë do të doja që komisioni të mblidhej pak më shpesh, jo kur të ndodhë diçka, por që të gjitha organizatat të kemi diçka për të referuar dhe për të përmirësuar në vazhdimësi.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Hajdarmataj!

Në fakt, nënkomisioni e kishte parashikuar mbledhjen para kësaj gjëje, ndërkohë që ju jeni njoftuar dhe e keni marrë ftesën ditë më parë, pasi të dyja nënkomisionet kanë çuar letrat në bashki për të marrë atë që thashë në fillim, *feedback*-un e tyre, përgjigjet zyrtare lidhur me funksionimin, problematikat apo mundësinë e krijimit të mekanizmit të referimit të dhunës.

Megjithatë, jam shumë dakord me sugjerimin tuaj, që duhet të jemi më proaktivë dhe me më shumë përgjegjësi, sidomos kur bëhet fjalë për monitorimin. Do të doja t'i thosha në fund, në fakt, konkluzionet dhe çfarë do të bëjmë më tej si nënkomision.

Po ia jap fjalën tani zonjës Adelina Farrici nga shoqata “Për autonominë vendore”. Singërisht, do të doja këndvështrimin tuaj, si mundet (përveç detyrimit ligjor, VKM-së, që është hartuar që në vitin 2011 për krijimin e mekanizmit të referimit të dhunës) që, vërtet përmes kërkesave, monitorimit, nxitjes, inkurajimit, pra përmes gjithçkaje, të bëjmë të mundur që të gjitha njësitë vendore të krijojnë mekanizmin e referimit të dhunës dhe, njëkohësisht, për ata që e kanë, si mund ta forcojmë punën e tyre?

Fjala është për ju.

Adelina Farrici – Faleminderit, e nderuar zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të qeverisë qendrore dhe të shoqërisë civile,

Faktikisht, unë dua të vlerësoj ftesën tuaj dhe këtë dëgjese, e cila adreson një çështje tejet problematike dhe shumë të ndjeshme për shoqërinë sot.

Unë përfaqësoj pushtetin lokal, i cili është një institucion i fuqishëm për çështjen për të cilën po trajtohet.

Pa dashur të zgjatem, dua thjesht të ndalem paksa te problematikat. Në fakt, është e pafalshme për pushtetin lokal që sot të kemi të pangritur mekanizmin e referimit të dhunës në familje. Realisht ai është një detyrim ligjor për çdo bashki që duhet të ishte e përfunduar, por, në këndvështrimin tim, edhe si ish-kryetare bashkie, nuk është shumë i rëndësishëm krijimi i një mekanizmi sesa është funksionaliteti i atij mekanizmi. Mendoj se realizimi i këtij funksionaliteti të mekanizmit, pavarësisht se lider në këtë mekanizëm është pushteti lokal, varet edhe nga shumë institucione të tjera.

Siç u përmend edhe nga parafolësit, edhe unë nuk dua të them se kush është pjesë përbërëse, por është shumë i rëndësishëm krijimi i një personi kontakti, i cili do të trajnohet dhe kualifikohet;

është një komision i përhershëm dhe jo që të ndryshojë në mënyrë të vazhdueshme, si dhe ndjekja me përparësi edhe nga pushteti lokal.

Problematikat e vëna re janë kryesisht mosfunksionimi dhe moskoordinimi, gjë që u soll edhe nga monitorimi që ishte bërë dhe që, në fakt, ishte paksa befasues edhe për mua, pasi unë kisha informacionin që në disa bashki funksionon mirë dhe realizohen në mënyrë periodike të gjitha mbledhjet e komiteteve dhe të mekanizmit. Paralelisht, si anëtare e shoqatës, unë kam bashki, të cilat ofrojnë shërbime të tilla, por unë dua të sjell në vëmendjen tuaj edhe diçka tjetër. Reforma territoriale e përballi pushtetin lokal me sfida të pafundme dhe nëse ne do të shkojmë në komisione të ndryshme, do të shikojmë se ku do të kërkohet që të ketë buxhetime të konsiderueshme për të gjitha funksionet që ka pushteti lokal.

Nëse shikoni buxhetin e pushtetit lokal, me arritjet dhe standardizimin e të gjitha këtyre funksioneve të saj, është e pamundur dhe, atëherë, kryetarët dhe administrata e bashkisë gjenden përballë problematikave të tilla që të fokusohen te prioritetet kryesore dhe buxhetimin ta ndajnë në varësi të kësaj.

Nëse do t'u referohemi të gjitha bashkive që e kanë ngritur këtë sistem, e kanë ngritur falë donacioneve dhe falë mbështetjes së donacioneve të ndryshme dhe të shoqërisë civile, ku, pas ngritjes dhe funksionimit njëvjeçar nga kjo mbështetje, pas atij momenti, është ndërgjegjësuar vetë bashkia dhe ka filluar funksionimi edhe nëpërmjet bashkisë. Këtu ne duhet të shikojmë me vëmendje, pavarësisht se është një buxhetim i vogël, por unë e shikoj si diçka pozitive që në buxhetet e bashkive e ke të përfshirë si zë për shërbimet sociale.

Është shumë i rëndësishëm fakti se është përfshirë ky zë, por më e rëndësishme është që ne të llobojmë fuqishëm, në mënyrë që ky zë të rritet.

Ka bashki që nuk kanë as një plan veprimi për barazinë gjinore dhe dhunën në familje. Por nuk është vetëm mungesa e dëshirës, por edhe kapacitetet e bashkive, sidomos bashkitë e mesme dhe të vogla, pra burimet njerëzore, nuk e kanë kapacitetin e tillë në hartimin e planeve të tilla, prandaj kërkojnë mbështetje nga shoqëria civile, pse jo edhe nga grante të ndryshme, madje, pse jo, edhe grantet qeveritare nuk duhet të fokusohen vetëm në drejtim të infrastrukturës, por të adresohen edhe në drejtim të këtyre problematikave që u ngritën këtu.

Një tjetër problem, këtë e them edhe nga eksperiencia ime personale, është se jo të gjitha rastet, madje pak raste e shikojnë zgjidhjen te referimi pranë komitetit në bashki. Shumica e rasteve janë të orientuara në polici dhe në gjykata. Unë mendoj se është shumë i rëndësishëm shkëmbimi

i të dhënave, pse jo, të përmuajshme ndërmjet pushtetit lokal dhe policisë ose prokurorisë, në mënyrë që pushteti lokal të ketë informacione të plota për të gjitha këto raste dhe, pas këtij momenti, të ndërtojë planin dhe të gjitha këto raste të referohen te mekanizmi, pasi nëse ky mekanizëm do të funksionojë mirë, realisht i ke të gjithë aktorët në tryezë; realisht shikohet e gjithë ecuria e problemit, sepse është gjykata, është prokuroria, është spitali (shëndetësia), por është edhe arsimiti, pra nëse të gjithë aktorët do të punojnë ashtu siç duhet dhe do të zbatojnë ligjin, do të kemi mjaft përmirësime në këtë drejtim.

Duhet të kemi parasysh edhe diçka tjetër, që nevojat e viktimave në familje janë të mëdha dhe, siç jua thashë pak më përpara, pamundësi financiare nga bashkitë që t'i mbulojnë këto nevoja. Bashkitë mund të japin një ndihmë të momentit dhe të çastit, por në vazhdimësi ose do ta referojnë te pushteti qendror... Pra, kemi shumë pak bashki, të cilat kanë strehëza qoftë edhe për 24 orë. Ky është një problem shumë i madh. Domethënë, paraqitesh te pushteti lokal dhe çfarë do të të bëjë pushteti lokal në qoftë se nuk ka një strehëz, në qoftë se nuk ka psikologun që paguhet pikërisht për këtë gjë, nëse nuk ka avokatin që t'ia ofrojë këtë gjë. Pra, nëse pushteti lokal nuk i ka këto, e vetmja gjë që do të bëjë pushteti lokal, dhe që realisht shumica e pushteti lokal e bën, është këshillimi që i bën dhe orientimi i drejtë se në çfarë institucione duhet të paraqitet, si dhe shoqërimi i personit të dhunuar te këto institucione.

Këto janë kryesisht problematikat. Ne si shoqatë angazhohemi për këtë që edhe në bashkitë, që janë anëtare të shoqatës sonë, ku nuk është ngritur mekanizmi i referimit të dhunës në familje, të koordinojmë me anëtarët tanë dhe paralelisht me aktorë të tjerë, në mënyrë që të ngrihet ky mekanizëm. Më tej ne mund të eidentojmë edhe raste të bashkive, të cilat e kanë një sistem referimi të mirë dhe model, dhe ta ndajmë këtë model edhe në bashkitë e tjera, pse jo edhe të bëjmë trajnime të tilla.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Farrici, për gjithçka, sidomos për faktin se ju angazhoheni që nëpërmjet bashkive, që janë anëtare pranë shoqatës suaj, të na ndihmoni për ta forcuar punën së bashku për të krijuar mekanizmin e referimit të dhunës në këto bashki, ku mekanizmat nuk janë krijuar ende.

Them se duhet të kemi bashkëpunim më të ngushtë me të dyja shoqatat e pushtetit vendor, pikërisht për ta monitoruar më mirë dhe për t'i nxitur që t'i ngrenë këto mekanizma.

Kush tjetër e do fjalën nga shoqëria civile?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam emrin tuaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di.

Linda Pino – Përshëndetje të gjithëve!

Jam Linda Pino dhe përfaqësoj koalicionin “Për arsimin në Shqipëri”.

Duke qenë se u njoftuam pak më vonë dhe konfirmimin e kemi bërë, thamë: okej, po futemi te lista e CRCA-së për të qenë të pranishëm në këtë takim.

Eglantina Gjermani – E kuptoj.

Linda Pino – Duke qenë pjesë e koalicionit “Për arsimin në Shqipëri” dhe shoh se një pjesë e anëtarëve të komisionit tuaj janë pjesë edhe e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, prej kohësh kemi ngritur problemin e dhunës në shkolla.

Nëse ne duam të kemi një shoqëri, e cila të jetë e përgjegjshme ose ta dojë vetveten dhe ta dijë se ku duhet të raportojë, se si duhet të silltet, atëherë kjo duhet të fillojë që në shkolla. Ne dimë se në shkolla ka një komision të etikës, por çfarë bën komisioni i etikës? Ka fëmijë të cilët raportojnë se janë të dhunuar, dhunohen me njëri-tjetrin dhe kemi fenomenin e bulizmit në shkolla; kemi mësues që dhunojnë fëmijët, por nuk dimë se ku duhet të raportojnë fëmijët në shkolla. Shkojnë te mësuesi i tyre, te psikologu i shkollës apo te drejtuesi i saj?

Në bazë DAR-i, ekziston figura e një personi, i cili është përgjegjës për sa u përket rasteve të dhunës. Nuk e di nëse keni parë ndonjëherë të ketë pasur ndonjë raportim nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për sa u përket rasteve të dhunës dhe si janë trajtuar ato.

Deri sot ne, si shoqëri civile, edhe pse kemi bërë kërkesa të vazhdueshme, nuk dimë të ketë një raport të prodhuar për sa u përket rasteve të dhunës në institucionet arsimore.

Duke qenë se po flasim për dhunën dhe për mekanizmin e mbrojtjes nga dhuna, ne nuk kemi në nivel shkolle një mekanizëm, i cili i mbron fëmijët nga dhuna.

Gjej rastin dhe kërkoj nga anëtarët, që janë pjesë e këtij komisioni, por që janë edhe pjesë e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, të ngrenë ose të kërkojnë një seancë dëgjimore për sa u përket rasteve të dhunës në institucionet arsimore. Jo më pak se disa ditë më parë është prezantuar një studim, ku thuhet: “70% e fëmijëve kanë raportuar se janë të dhunuar”, si dhe në një tjetër studim, si BECAN-i, thuhet se 65% e fëmijëve raportojnë se kanë qenë të abuzuar qoftë nga ana psikologjike, qoftë nga ana fizike. Pra, nëse ne duam një qasje

multidisiplinare për sa i përket dhunës, do të ishte mirë që kjo të fillonte që në bankat e shkollës, madje atje duhet të jetë edhe ndërhyrja e parë për të shkuar më tej.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit për ngritjen e këtij problemi kaq të rëndësishëm!

Fjalën e ka zëvendësministrja për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe pas saj ne, si kolegë, për ta përmbyllur.

Ardiana Jaku – Shumë faleminderit!

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në fakt, punon në dy drejtime kryesore: në drejtimin parandalues dhe në trajtimin e rasteve ku viktimat e dhunës janë në marrëdhëniet familjare.

Po e përmbledh në mënyrë që t'u jap përgjigje edhe pyetjeve të ngritura apo edhe shqetësimeve që dolën nga prezantimet e organizatave ose të shoqatës për autonominë vendore.

Fushatat ndërgjegjësuere nuk bëhen vetëm. Ministria ka rol koordinues qoftë me pushtetin lokal, qoftë me organizatat e shoqërisë civile kombëtare ose ndërkombëtare, por, pa diskutim, që ky rol nuk mund të kuptohet, po ashtu, edhe me institucionet e tjera të qeverisjes qendrore, ministrive të linjës. Pra, të gjithë bashkëpunojmë dhe koordinohemi në mënyrë që të kemi jo vetëm një fushatë në vit, që është “fushata e gjashtëmbëdhjetë ditëve”. Gjithashtu, herë pas here kemi bërë fushata dhe nisma ndërgjegjësuere në lidhje me këtë fenomen.

Për sa i takon pjesës së trajtimit të rasteve, pa diskutim, rolin kryesor e kanë mekanizmat e referimit, që ndodhen në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këtu dua të theksoj se kemi një plan qoftë për trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve, të atyre mekanizmave që tani janë funksionale, qoftë një plan takimesh në mënyrë që të nxiten, të ngrihen mekanizmat e referimit edhe në bashkitë ku mungojnë. Pra, kjo është në planet tona që i kemi tashmë në zbatim. Ministria ka një sektor të posaçëm brenda ministrisë, që targeton dhe merret posaçërisht me këtë çështje.

Për sa i takon arsyes se si mund të rrisim efikasitetin e mekanizmave të referimit, kjo është një çështje komplekse, e cila ka të bëjë me kapacitetet njerëzore që janë pjesë e këtyre mekanizmave, me buxhetimin që i jepet e, gjithashtu, ka të bëjë me koordinimin e punës së tyre. Janë këta 3 faktorë që deputetja i përmendi dhe unë duhet t'i theksoj. Të gjithë bashkë kur e dëgjuam, ramë dakord që të tria duhet të targetohen dhe të punohet fort me to.

Për sa i përket Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ndryshimet ligjore që u bënë, kishin lidhje pikërisht me forcimin e këtyre 3 sfidave që ne kemi. Në ligjin nr. 47 që ka

ndryshuar tani është specifikuar se punonjësi i barazisë gjinore dhe i dhunës në bashki duhet të jetë punonjës social. Pra, ai nuk mund të jetë i një shkollimi tjetër, sepse duhet t'i adresojmë mirë çështjet, të cilat i vijnë për t'u trajtuar dhe menaxhuar. Modulet e trajnimeve që do të përdoren për trajnimin e anëtarëve të mekanizmit të referimit, do të miratohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtëse Sociale dhe nga ASPA. Ato do të konsultohen gjithashtu, edhe me Urdhrin e Psikologut, edhe me Urdhrin e Punonjësit Social. Këtë e kemi të vendosur në ligj në mënyrë që të gjitha trajnimet që vijnë të jenë të mirëkoordinuara dhe të shkojnë me të vërtetë aty ku kanë nevojë dhe për atë që ka nevojë. Kjo vënte si një kërkesë e organizatave të shoqërisë civile. Gjithashtu, edhe një rekomandim i GREVIO-s për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj dhunës.

Dua të sqaroj një çështje që Altini e ngritit me të drejtë, që është Fondi Social dhe ndërmarrjet sociale. Fondi Social është një VKM që vjen në zbatim të ligjit nr. 121 për shërbimet shoqërore. Kjo është e ndryshme nga ligji për ndërmarrjet sociale. Fondi Social është specifikisht për t'u ardhur në ndihmë bashkive për ngritjen e shërbimeve shoqërore apo për forcimin e atyre shërbimeve aty ku janë ngritur tashmë. Kjo nuk ka lidhje me ndërmarrjet sociale, që janë një gjë krejt tjetër për të cilat besoj se do të diskutojmë në një moment tjetër.

Çfarë ka si synim Fondi Social? Përmes bashkimit të buxheteve, të pushtetit qendror, atij vendor apo të donatorëve të ndryshëm, të organizatave kombëtare apo ndërkombëtare, gjithashtu edhe tarifimit, që mund të kenë shërbimet e ndryshme, përmes këtij fondi, do të ndihmohen bashkitë përmes një formule të përlllogaritur që të ofrojnë shërbimet shoqërore në lokalitetet e tyre. Kisha nevojë ta sqaroja këtë.

Një përgjigje të fundit, për qendrat që ekzistojnë tashmë për të cilat Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale jep fonde nga financat e shtetit, kemi Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje. Janë edhe 6 subjekte jopublike, të cilat ofrojnë shërbime rezidenciale: dy në Tiranë, një në Korçë, një në Berat, një në Elbasan dhe një në Vlorë. Nga këto qendra, tri qendra jopublike, në Tiranë, në Elbasan dhe në Vlorë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i financon pjesërisht.

Ndërkohë, pyetja që me të drejtë ngriti deputetja ishte: Pse nga 14 përfitues në Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje, vetëm 6 viktimat kanë pasur mundësi të punësohen? Çështja e punësimit është sensitive, është ajo drejt së cilës ne duam të shkojmë, është vizioni ynë jo vetëm për gratë që përjetojnë dhunë në familje apo viktimat e trafikimit.

Gjithashtu, për të gjithë individët e aftë për punë, të cilët ne i targetojmë me programet tona të mbrojtjes sociale (sa për sqarim), sfidat e punësimit kanë të bëjnë me arsimin e pamjaftueshëm që kanë personat që ne trajtojmë.

Ato kanë të bëjnë me oraret e zgjatura dhe vështirësinë që krijohet.

Dy prej rasteve që nuk janë përfshirë në punësim kanë lidhje me probleme të shëndetit mendor.

Dy të tjera e kishin të pamundur të punonin, sepse fëmijët e tyre kishin probleme shëndetësore. Njëra është me fëmijë shumë të mitur, ndërsa një tjetër është shtatzënë. Dy raste të reja kanë aplikuar në zyrat e punësimit dhe ne po presim vendimin prej tyre. Vetëm për të specifikuar shifrën që dhashë në fillim, pse nga 14 vetëm 6 janë punësuar, ka disa arsye. Kuptohet se arsimimi i tyre është baza. Gjithashtu, ka disa specifika që lidhen me rastet konkrete.

Nuk e di nëse lashë ndonjë gjë pa përmendur. Besoj se diskutimet e tjera shtojnë vëmendjen që çështjet sociale të mos jenë pas të gjitha çështjeve të tjera, por të jenë të fokusuar aty qoftë për pushtetin qendror, qoftë për atë vendor, edhe si rezultat i punës që OJQ-të bëjnë.

Shumë faleminderit!

Eglantina Gjermani – Zoti Azizaj, keni diçka për ta përmbyllur në lidhje me këtë që u tha?

Altin Hazizaj – Një rekomandim: do të ishte mirë që të jetë gjithmonë edhe Ministria e Arsimit, sepse siç tha me të drejtë Linda, ne kemi shumë probleme të dhunës në familje që pasqyrohen në shkollë, ndërkohë nuk ka një regjistër dhe procedura të raportimit të tyre. Nëse kemi një ndërhyrje të hershme, sepse ne si ekspertë të të drejtave të fëmijëve dhe të grave themi gjithmonë se duhet ndërhyrja e hershme. Ne nuk e kemi sistemin e ndërhyrjes së hershme. Kjo mund të jetë një mënyrë për ta ndërtuar këtë sistem.

E dyta, është çështja e Fondit Social. Kjo është për korrektesë ligjore për mua dhe vlen edhe për ju: VKM-ja nr. 111, dt. 23.2.2018, pika 5.1 thotë: “Të gjitha shërbimet e përkujdesjes shoqërore, të parashikuara në kreun II, të ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror, të cilat konsiderohen si parësore nga bashkia, por që nuk mund të ofrohen prej saj, mund të ofrohen nga organizata jofitimprurëse, si ndërmarrje sociale apo struktura të ngjashme me to, që operojnë në këtë fushë private.” Këtë e thotë VKM-ja, jo unë.

Rekomandimi i fundit që kam. Nuk ka një metodologji se si dhe çfarë duhet të bëjnë bashkitë për përdorimin e Fondit Social. Qeveria ka vetëm detyrimin të përcaktojë Fondin Social.

Menaxhimin e tij nuk e bën qeveria. Për ne kjo është një mangësi e theksuar, sepse eliminon financimin e shërbimeve kombëtare, strehët, të paktën në Tiranë, janë shërbime kombëtare. Ato nuk ofrohen vetëm për Tiranën. Alo 116 është shërbim kombëtar, Linja e Telefonit për Gratë dhe për Vajzat, është shërbim kombëtar. Kjo do të thotë se ne jemi të përjashtuar automatikisht nga kërkesa për fonde, sepse me të drejtë Bashkia e Tiranës të thotë se të jep 1/61-tën e fondit tënd, sepse ti je për të gjithë Shqipërinë dhe nuk je vetëm për Tiranën.

Pra, ka një logjikë të munguar në këtë aspekt.

E dyta, është një rekomandim për të dyja nënkomisionet. Jemi ende në kohë që VKM-në e Fondit Social ta kthejmë në ligj. Gjysma e punës është gati për të mos thënë $\frac{3}{4}$ -t. Hajdeni ta shohim me vëmendje, se jemi ekspertë të mirë, si të çështjeve sociale, ashtu dhe të fushës së ligjit! Nuk na gjen gjë, nëse harxhojmë 2-3 javë dhe e sjellim me procedurë të përshpejtuar që ai të jetë ligji për krijimin e Fondit Social në nivel kombëtar, me procedura të sakta që askush të mos abuzojë duke zgjidhur përfundimisht dilemën që e thashë kur raportova, që është procedurale. Të paktën ta dimë që në nivel kombëtar do të kemi 2-3-5 shërbime që viktimat edhe sikur të mos asistohet (me të drejtë Shoqata e Bashkive thotë se ka bashki të vogla dhe ato nuk mundin), por të paktën ne, që jemi në Tiranë, të mund t'i asistojmë këto viktimat. Pse jo? Nuk ka asnjë gjë të keqe. Shqipëria është një vend i vogël. Me rrugët e reja që po bëhen, tani shkon për 2-3 orë në çdo cep të vendit, po të duash.

Eglantina Gjermeni – Shumë faleminderit!

Falënderoj të gjithë kolegët deputetë për komentet!

Sigurisht, do të kemi një mbledhje tjetër për të diskutuar në lidhje me çfarë do të bëjmë më tej dhe hapat tonë të mëtejshëm për t'i adresuar të gjitha problematikat dhe sugjerimet. Në qoftë se do dikush të marrë fjalën, është i mirëpritur.

Urdhëroni!

Milva Ekonomi – Unë nuk kam më pyetje, sepse pyetjet që shënova në përgjithësi, patën përgjigje nga diskutimet e përfaqësuesve të shoqërisë civile. Në fakt unë dua të them dy gjëra, që mendoj se janë të rëndësishme.

Dhuna në familje është një fenomen shumëvjeçar në Shqipëri dhe ka një mirënjohje qytetari i angazhuar, i cili në këtë rast vjen nga përfaqësimi i shoqërisë civile, që ka bërë presion. Presioni i tyre solli ndryshimet ligjore, të cilat ne, si parlamentarë, i morëm përsipër në këtë rast.

Ai bëri edhe ndryshime në mënyrën si qaseshin shërbimet. Ajo që dua të them është se mendoj që rezoluta, të cilën ne e kemi miratuar njëzëri në parlament nga të gjitha forcat politike, një rezolutë shumë gjithëpërfshirëse. Kam përshtypjen se po të ndjekim rezolutën arrijmë të bëjmë më të mirën për t'i dhënë një shërbim ashtu siç duhet komunitetit në rastet e dhunës në familje.

E dyta, ne kemi ndryshuar disa ligje, si ligjin për strehimin social, ligjin për shërbimin ligjor falas, apo edhe ndryshimet që kemi bërë për policimin në komunitet, që është një shërbim i ri.

Duke folur këto ditë në lidhje me këtë gjë me Ministrinë e Brendshme, unë u informova se nevoja për të pasur një rol më të drejtë të policit në komunitet, si duhet ta kryejë ai rolin, vjen edhe nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta, të shoqërisë civile dhe të policëve në komunitet, që edhe pjesa që u ngrit nga ne, mungesa e koordinimit midis aktorëve të mekanizmit të referimit, të fillojë dhe të kuptojë se ku janë mangësitë dhe në një farë mënyre, të zgjidhet.

Megjithatë, unë mendoj (duke u mbështetur edhe te diskutimi që kam bërë me Elonën dhe me Vasilikën), se ka nevojë edhe për një libër, një udhërrëfyes, një udhëzues për disa gjëra që janë shumë të rëndësishme. Të gjitha këto diskutime ligjore që ne bëjmë, që duket sikur janë probleme, por në fakt e kanë zgjidhjen, duhen vendosur në një paketë të përbashkët, që të jetë më e lehtë puna edhe për ata që janë të angazhuar në shoqërinë civile, por edhe për ne, kur monitorojmë. Kjo është e para.

E dyta, mbase edhe mekanizmi i veprimit ka nevojë për një doracak, i cili të jetë në përdorim të të gjithë njerëzve që janë në shërbim.

E treta, që është shumë e rëndësishme, është se ne jemi në fazën e diskutimit të buxhetit për vitin 2019. Unë ju falënderoj shumë që na vutë në dijeni për presionin që duhet të bëjmë për buxhetin e këtij viti!

Edhe të dhënat që u dhanë nga përfaqësuesi i UN-së për me përqindjen që ka Fondi Social në PBB, kërkohet të rritet. Çdo herë që marrim një gjë më shumë, duhet të jetë diçka më e vlefshme. Do të ndihmojmë për të bërë presion për të rritur Fondin Social me aq sa kemi mundësi. Unë mora shënime edhe për një dëgjese që duhet bërë në komisionin tonë lidhur me dhunën ndaj fëmijëve në shkolla, kështu që së shpejti do të kemi një kalendar edhe për këtë aktivitet.

Së fundi, dua të theksoj rastin e vajzës nga Kruja, që ne, si deputete të PS-së në radhë të parë duam të mbrohet e drejta e vajzës dhe për këtë gjë luftuam fort dhe unë besoj se kjo është

një nga gjërat që duam të gjithë. Mbi të gjitha, ne duam që të veprojë ligji dhe askush të mos jetë i përjashtuar nga ligjvënia në Republikën e Shqipërisë.

Për ne këto janë angazhime shumë të forta dhe unë besoj se me të gjitha koleget deputete ndajmë angazhimin se të gjithë jemi të barabartë përpara ligjit.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Shumë faleminderit, zonja Ekonomi!

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea Hoxha – Sa për sqarim. Protokollet e veprimit për të gjithë anëtarët e mekanizmit të referimit janë gati. Ato janë hartuar me ndihmën e UNFPA-së dhe janë gati për konsultim.

Eglantina Gjermeni – Shumë faleminderit, për sqarimin! E vlerësojmë shumë. Edhe ne do të donim të jemi pjesë e konsultimit. Është shumë e rëndësishme...

Faleminderit!

Elona Gjebrea Hoxha – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, të nderuar përfaqësues të shoqërisë civile, zonja zëvendësministre dhe gjithë përfaqësues të pushtetit lokal!

Për fat të keq, megjithëse kisha dëshirë shumë të madhe të isha prezente sot gjatë gjithë mbledhjes, për shkak të angazhimeve në dy komisione të tjera nuk munda, por do të mblidhemi me kolegët dhe do të diskutojmë më në detaje.

Të gjithë kemi punuar dhe kemi ndjekur me shqetësim rastin e fundit dhe raste të tjera, por, nisur nga ky rast, është e nevojshme të kemi një komunikim më të shpeshtë midis nesh dhe shoqërisë civile për problematika që dalin herë pas here. Të mos i grumbullojmë dhe pastaj ta kemi të vështirë për të vendosur rendin e gjërave. Ashtu sikurse mendoj që në momentin që krijohet një mekanizëm referimi, duhet patjetër që të bëhen procedurat standarde. Nuk mund të lihen në një etapë tjetër, sepse pastaj këto fillojnë dhe krijojnë boshllëqe. Këtë e them edhe nga përvoja ime me mekanizmin kombëtar të trafikimit kundër personave, pavarësisht se ka qenë një mekanizëm pak më i kollajshëm, sepse pushteti lokal ishte i ndarë, por gjithsesi ishte brenda. Mua më është dashur të futem në një pazëll dhe të orientohem në të gjitha këto struktura, që në fund të fundit duhet të koordinohen, duke kuptuar që është shumë e vështirë dhe ndonjëherë e gjithë ajo punë e madhe, me një rast konkret apo dy raste, shuhet. Edhe kjo nuk është e drejtë. E kuptoj të gjithë revoltën apo atë çka ne mund të ndiejmë. E rëndësishme është që ne të rregullojmë ato mangësi që

shfaqen. Në këtë rast, si përfaqësuese dhe si nënkryetare e Aleancës së Grave Deputete, dëshiroj ta ndaj me ju, meqenëse është një rast i mirë për të diskutuar, që, në fakt, ne kemi qenë të vonuar. Tashmë Aleanca e Grave Deputete është krijuar dhe ka një plan veprimi që ngelet për t'u finalizuar vetëm nëpërmjet një mbledhjeje. Padyshim ne kemi në një nga tre prioritetet tona edhe luftën kundër dhunës. Kështu që, në të gjitha këto, ndoshta mund të ketë nevojë edhe për një monitorim në nivel kombëtar, por edhe disa fushata ndërgjegjësuese ku zëri i bashkuar i politikës dhe shoqërisë civile mund të ndihmojë më shumë dhe Aleanca mund të luajë një rol.

Padyshim që nënkomisioni ka një peshë kryesore dhe unë dua ta falenderoj kryetaren, por mendoj që me një bashkëpunim të mirë dhe me një komunikim, që mund ta vëmë edhe si një rregull, 1 herë në 3 muaj, do të na ndihmojë shumë që të gjitha këto mangësi ne t'i adresojmë në kohën e duhur.

Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zonja kryetare!

Dua të falenderoj të gjithë pjesëmarrësit dhe përfaqësuesit e qeverisë!

Në vazhdim të asaj çfarë tha kolegia kam dy sugjerime. Kam mbajtur shënim gjithçka. Padyshim, ne kemi një sërë detyrash për të përmbushur, jo vetëm në nënkomisionin e Barazisë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës, që ka barrën më të madhe, por ka edhe një sërë komisionesh dhe nënkomisionesh të tjera dhe grupime. Unë do t'i inkurajoj fort anëtarët e shoqërisë civile, që janë pjesë e Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore, që të zhvillojmë një mbledhje sa më shpejt. Do të vlerësonim shumë (këtë do t'ia përcjell edhe Kryetarit të Kuvendit, i cili drejton mekanizmin ndërinstitucional për zbatimin e rekomandimeve në aspekte të ndryshme), të kishim një hartë të të gjitha bashkive ku është mekanizmi dhe cilat janë organizatat që punojnë dhe mbulojnë dhe çfarë mbetet pa mbuluar. Kjo është e mirë për të orientuar donatorë dhe fonde, sepse shikoj që ka mbivendosje. Të gjithë rendin të monitorojnë vendimet e Gjykatës së Tiranës, ndërkohë mendoj që ka organizata shumë të specializuara që mund ta bëjnë. Mjafton një dhe të tjerat të hidhen në shërbime, sensibilizime, edukime e të tjera.

Së dyti, do të ishte me shumë interes të kishim një informacion për bashkitë, që nuk i kanë këto mekanizma dhe një inventar se a ka shoqëri civile që operojnë aty apo të gjitha organizatat kanë ardhur dhe punojnë në Tiranë. Sa fonde ka agjencia që mbështet shoqërinë civile, sepse mund

të jetë një adresim shumë i mirë edhe për agjencinë për të përcaktuar prioritetet? Besoj se kemi anëtarë në këtë agjenci, por për ne do të jetë shumë mirë kur të diskutohet buxheti për organet e qeverisjes vendore për çdo bashki. Mund të themi që kjo bashki ka nevojë për më shumë fonde dhe nuk ka kjo për këtë apo këtë arsye. Ne që jemi në Komisionin e Ligjeve, në nënkomisionin për qeverisjen vendore, por njëkohësisht edhe nënkomisionin për të drejtat e njeriut, nuk e disponojmë këtë informacion.

Së fundi, do të vlerësoja shumë, zonja kryetare, nëse do të mund të zhvillojmë një seancë tjetër, por jo për të thënë më cilat janë problematikat, por çfarë veprimesh do të ndërmarrin institucionet, çfarë ka marrë përsipër shoqëria civile dhe çfarë mbetet për Kuvendin. Nuk mund të vazhdojmë të themi të gjithë: “përgjegjës, përgjegjës”. Po të bëjmë bilancin se çfarë përgjegjësish ka secili prej nesh, do të shikojmë se çfarë detyrash ka. Kuvendi nuk mund të bëjë çdo gjë, nuk ofron shërbime. Kuvendi nuk mund të bëjë prokurorin, punonjës të policisë, shoqërinë civile, por pjesën e ligjeve dhe të monitorimit të zbatimit të ligjeve.

Në muajin dhjetor Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë do të nxjerrë një raport të situatës të gjendjes të të drejtave të njeriut në Shqipëri para se të raportojë Avokatja e Popullit. Nëse ne nuk do të kemi të gjithë këtë lloj informacioni të ndarë me komisionin, sidomos me Komisionin e Barazisë Gjimore, me qëllim që të kemi edhe ne hapa konkretë, atëherë mund të themi që Kuvendi ka bërë apo nuk ka bërë. Unë mendoj se është e nevojshme të prodhojmë pak sinergji dhe duhet të jemi pak më proaktivë.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Hysi!

Fjalën e ka zonja Xhembulla dhe më pas zonja Dhima.

Almira Xhembulla – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, do të marr shkas nga diskutimi i koleges Vasilika me që kam pak a shumë të njëjtën ide.

Falenderoj zonjën Jaku për prezantimin shumë të mirë! Në një farë mënyre ramë të gjithë dakord që në aspektin e nismave ligjore dhe kuadrit ligjor ne kemi bërë hapa përpara. Pa diskutim, një meritë të mirë në këtë aspekt ka edhe nxitja dhe shtypja që i ka dhënë këtij procesi edhe shoqëria civile. Duhet ta pranojmë këtë gjë. Ne kemi këtu një përfaqësuese nga shoqata e autonomisë vendore, që është zonja Farici, e cila në një farë mënyre nxori në pah edhe problematikat që ajo dëgjon nga kontakti i vazhdueshëm me anëtarët e shoqatës. Ata sot nuk janë të pranishëm këtu,

ndërkohë që ne si përfaqësuese të Kuvendit dhe ju si organizata të shoqërisë civile dhe përfaqësues të ministrisë, themi që secili nga ne në një farë mënyre ka bërë atë që i takon. Pa diskutim, është një zinxhir, i cili duhet të jetë i mbyllur në mënyrë që të funksionojë në mënyrë eficiente.

Themi që mekanizmi ka probleme, por duhet të vijmë nga fillimi, që nuk kishim mekanizëm fare. Unë kam qenë prezente në momentin që mekanizmi i referimit të dhunës u ngrit dhe instalua në disa bashki. Falenderoj shumë organizatat dhe UNDP-në, të cilat e shtynë këtë si proces! Jam shumë dakord me atë që tha zonja Farici, që kur flasim për mundësitë dhe kapacitetet e pushtetit lokal, qëndrueshmëria e burimeve njerëzore është një ndër sfidat që ata kanë, sepse ata përcaktojnë një person, i cili është personi kontakti për këtë çështje, më vonë për arsye të ndryshme ky person mund të mos jetë më. Në këtë moment zhbëhet komplet pjesa që lidhet me investimin që bëhet për të ngritur mekanizmin.

Ardiana theksoi që ne po i mësojmë shumë pjesës që ka të bëjë me *background*-in e punonjësve apo përfaqësuesve të pushtetit lokal. Në një farë mënyre është shumë mirë që t'i detyrojmë dhe të mos lëmë asnjë hapësirë që ata të kenë qoftë edhe nuanca politike në përzgjedhjen e këtyre personave. Kështu që, kjo është një garanci tjetër.

Nuk e di se sa nga ju, këtë e kam me përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe si ish-kolege juaja, e kanë ndjekur atë çfarë ne folëm në momentin që aprovuam projektligjin për ndryshimet në ligjin për parandalimin e dhunës në familje. Ne kemi qenë ndoshta po aq sa edhe ju shumë kërkues dhe shumë të sinqertë për të renditur dhe adresuar të gjitha problematikat që hasen në këtë sektor. Jemi shumë të vetëdijshëm. Ne po themi që kemi ngritur një mekanizëm, por unë vij si përfaqësuese e një zone, që është pak larg, dhe duhet të jemi të ndërgjegjshëm që jemi përballë një mekanizmi, i cili është ngritur në vite, që mbase akoma (më vjen keq që e them), nga përfaqësuesit që punojnë në administratë dhuna nuk konsiderohet problem. Përballë kësaj është një përpjekje jona e përbashkët dhe të paktën në këtë gjë biem të gjithë dakord. Pa diskutim ne kemi pjesën më të madhe tonën. Kemi një fenomen i cili kërkon shumë angazhim, kohë dhe të vëmë zemrën në këtë gjë. Unë e di shumë mirë, sepse kam punuar me shumë kolege të nderuara, që kanë punuar në situata ekstremisht të vështira, ashtu siç u shprehën edhe sot këtu, që kemi të bëjmë edhe me raste kur ...

Në Dibër nuk ka fare qendër në që mund të funksionojë mekanizmi, por akoma nuk kemi një qendër qoftë edhe 3-ditore për t'i trajtuar këto raste. Di që kjo është një përpjekje e bashkisë me disa organizata, por që nuk e kemi për momentin. Duke qenë se shumica nga ne jemi marrë me

këto lloj procesesh, dua t'ju siguroj që ne do të bëjmë çfarë të jetë e mundur. Më pëlqeu argumenti që dha zonja për sa i përket kërkesës që duhet të kemi ndaj Autoritetit të Mediave Audiovizive, AMA, sepse të gjithë elementët përbëjnë të tërën. Kështu që, nëse përpjekjet bëhen të përbashkëta, ne mund ta luftojmë dhe të jemi më shumë efikas ndaj këtij fenomeni, i cili ekziston në të gjithë botën dhe për këtë jemi të vetëdijshëm.

Për sa i përket rastit të fundit, i cili jo vetëm ka krijuar një interes të madh publik, por që është shumë i ndjeshëm dhe sensitiv, dua të them, edhe pse koleget e sqaruan shumë mirë pozicionin tonë si deputete, se unë i shikoj gjithmonë këto raste jo përgjithësuëse, por që na bëjnë ne të reflektojmë, mësojmë, shikojmë dhe qenë sa më të kujdesshëm në detyrat tona për të bërë punën në mënyrën më të mirë të mundshme.

Ju falenderoj dhe uroj të gjithëve punë të mbarë që të bëjmë sa më shumë hapa përpara në drejtim të parandalimit, trajtimit dhe dënimit të rasteve të dhunës!

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Xhembulla!

Fjalën e ka zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Falenderoj zonjën zëvendësministre dhe shoqërinë civile që është prezente në këtë takim të organizuar nga nënkomisioni.

Në fakt, nënkomisioni, anëtare e të cilit jam edhe unë, ka filluar punën e vet në bazë të një plan veprimi, pjesë e të cilit është edhe takimi i sotëm. Unë e dëgjova prezantimin dhe më vijnë në mendje disa pyetje për zonjën zëvendësministre.

A mendoni ju se statistikat që janë raportuar nga institucionet për dhunën në familje janë reale apo ka raste, siç dëshmohet nga bashki që kanë raportuar pranë këtij komisioni, që dhuna nuk denoncohet për shkaqe që vijnë nga mungesa e pavarësisë ekonomike apo nga niveli i emancipimit të grave në zonat rurale?

Kam edhe një pyetje tjetër për shoqatën e bashkive, por edhe për shoqërinë civile. Në fakt, bashkitë paguajnë një kontribut pranë shoqatës suaj dhe, në kërkesën që i janë drejtuar nënkomisionit kanë kërkuar asistencë teknike për të gjithë personat, të cilët merren me dhunën në familje në institucionet pranë bashkive.

A mendoni se keni burime të mjaftueshme financimi për të trajnuar personelin që merret me këtë problem pranë bashkive?

Dihet që shumë organizata dhe shoqata financojnë ose ofrojnë trajnime të ndryshme. Unë nuk e di se ku raportohen këto shpenzime që këta donatorë harxhojnë për trajnimin ose për problematika të ndryshme të dhunës në familje dhe se çfarë monitorimi ka pas kryerjes ose pas përfundimit të trajnimit, pas përfundimit të dhënies së asistencës e të tjerë.

Kam një pyetje për Aurelën.

Aurela, ju drejtoni qendrën për nisma ligjore dhe qytetare. Pyetja ime është: Sa është numri i viktimave që ju keni ndihmuar për vitin 2018? Ku ndodhen këto viktima aktualisht? Nëse ndonjë organizatë ose shoqatë tjetër e ka këtë informacion, është e lutur të na informojë.

Faleminderit!

Eglantina Gjermani - Shkurtimisht, nëse zonja Jaku do të kthejë përgjigje. Pyetjet, ju lutem, bëjini sa më shkurt, sepse kemi tejkaluar çdo kohë!

Ardiana Jaku – Të dhënat, që ne si ministri raportojmë, merren nga sistemi REVALB. Sistemi REVALB është një sistem elektronik, ku çdo nëpunës i barazisë gjinore në njësinë vendore, hedh të dhënat për rastet që janë trajtuar dhe menaxhuar nga mekanizimi i referimit. Kështu që të gjitha të dhënat i marrim aty. Nga ana tjetër, të dhënat i marrim edhe nga drejtoria e policisë për rastet që ata raportojnë dhe ndjekin, por janë edhe ata pjesë e të dhënave që ne raportojmë.

Eglantina Gjermani – Faleminderit!

Zonja Bozo...

Aurela Bozo – Në lidhje me pyetjen, qendra për nisma ligjore dhe qytetare ofron përfaqësim ligjor për rastet vetëm në Tiranë, ndërkohë që ofron këshillim ligjor falas dhe përgatit akte për rastet në të gjithë vendin.

Kështu që në qoftë se do ta shohim krahasimisht, nëse vite më parë ne trajtonim deri në 4 viktima në ditë, aktualisht kemi arritur të trajtojmë 7-10 viktima në ditë. Natyrisht, jo viktima të reja, por edhe gra dhe vajza, që mund të vijnë herë pas here, domethënë që marrin disa sesione. Kështu që me dosje, duke përfshirë edhe përfaqësimin ligjor në gjykatat e niveleve të ndryshme, ne kemi rreth 700 viktima të mbështetura, pra kjo përfshin edhe përfaqësimin ligjor, ndërsa numri i këshillimeve, duke përfshirë këshillimet ballë për ballë, *online*, si dhe këshillimet me telefon, është shumë i lartë.

Eglantina Gjermani – Shumë faleminderit ekipit tuaj, zonja zëvendësministre!

Faleminderit të gjithëve, miq dhe kolegë të shoqërisë civile, për gjithë punën tuaj, angazhimin dhe durimin, si dhe për çdo gjë të vlefshme që ndatë sot me ne, për përvojat dhe sugjerimet për ta bërë punën më mirë bashkë!

Pa dyshim, faleminderit edhe deputetëve që janë anëtarë të Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas, si dhe kolegeve deputete nga Aleanca e Grave Deputete!

Kërkoj ndjesë, sepse për shkak të angazhimeve si ditë e hënë, jo të gjithë mundën të qëndrojnë gjatë gjithë kohës, por, sinqerisht, besoj se për të gjithë ishte shumë e vlefshme kjo seancë.

Edhe një herë, shpreh keqardhjen që deputetët e opozitës nuk janë të pranishëm, jo vetëm për faktin se çështja e dhunës na prek të gjithëve. Mendoj dhe jam e ndërgjegjshme, edhe nga monitorimet që keni bërë, që rasti i Krujës dhe çdo rast tjetër që mund të ndodhë apo ka ndodhur, janë raste që jo të gjithë i dimë dhe se ka raste për të cilat mekanizmi nuk funksionon apo ka problematika, të cilat i pengojnë vajzat dhe gratë të marrin shërbimet e caktuara. Ne duhet t'i kemi çështje të rendit të ditës këto raste.

Besoj se me sugjerimet tuaja të vlefshme, nënkomisioni do të jetë shumë më proaktiv, për sa i përket nxitjes së të gjitha njësive vendore për të forcuar mekanizmin, për të krijuar mekanizmin e referimit të dhunës në bashkitë ku nuk është krijuar dhe, pa dyshim, për ta ndarë informacionin bashkë me ju.

Kam një kërkesë specifike për të gjithë ju, miq nga shoqëria civile: çfarëdolloj problemi që hasni në punën tuaj, meqenëse po flasim kaq shumë për këtë çështje, ju lutem, na kontaktoni! Përveç njohjeve personale që kemi me secilin prej jush, edhe institucionalisht jemi më se të angazhuar për të qenë proaktivë dhe për të qenë bashkë në të gjitha këto përpjekje. Pa dyshim, roli dhe përgjegjësia jonë si deputetë dhe si politikbërës është shumë më e madhe, por kërkojmë edhe mbështetjen, sinjalizimin, si dhe që informacionin ta ndajmë së bashku, që të mos lejojmë krijimin e problemeve të tilla.

Së fundi, dua të theksoj që ne sot folëm shumë për mekanizmin e referimit të dhunës, folëm shumë për faktin që ka probleme, por pak ose aspak përmendëm modelet pozitive që ekzistojnë. Ky është një sugjerim shumë miqësor, në fakt, sepse vërtet problemet që hasin viktimat janë probleme madhore, që janë kambana alarmi, por sugjeroj që të gjithë së bashku të promovojmë edhe modelet pozitive të punës, sigurisht, duke respektuar konfidencialitetin e viktimave, por ama

të themi edhe ku funksionon ky model dhe si funksionon dhe jo vetëm ta ndajmë me bashkitë e tjera për të ndarë përvojat, por edhe me publikun, që rastet dhe puna juaj e përditshme, puna jonë e përbashkët, e përditshme, të ketë rezultate shumë më të mëdha se rastet që vërtet, e theksoj, duhen minimizuar dhe eliminuar plotësisht. Për sa i përket kësaj, duhet ndërgjegjësimit i opinionit publik, trajnime, edukim për dhunën në shkolla, që u ngrit si shqetësim, por edhe edukim gjinor për t'i trajtuar si të barabartë vajzat dhe djemtë, që të mos mësohen vajzat të jenë viktime. Është diçka që duhet bërë nga të gjithë aktorët. Kështu që them se duhet një punë e përbashkët me të gjithë deputetët, bashkë me shoqërinë civile, pa dyshim, edhe me institucionet e qeverisë qendrore dhe të pushteti vendor. Mendoj se do të jemi në të njëjtin krah të llogores për t'i adresuar këto probleme.

Edhe një herë, faleminderit!

Do të jemi në kontakt për çdo të re, për nismat dhe hapat e mëtejshme që ne si nënkomision do të ndërmarrim.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA